

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5643  
E hënë, 3 dhjetor 2018  
çmimi 0.40 €

## LDK-ja dhe LV-ja kundër propozimit të PSD-së për dialogun

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

#### LAROT E RETORIKËS F. 11

Hasan MUJAJ



#### KDI-JA NIS AKTIVITETET NË KUADËR TË MUAJIT KUNDËR KORRUPSIONIT F. 5

#### KCSF-ja: SHOOËRIA CIVILE MBETET FAKTOR I RËNDËSISHËM PËR DEMOKRATIZIMIN E VENDIT F. 6

### EKONOMI

#### DOGANA: HYRJA E MALLRAVE KOMERCIALE NË KOSOVË VAZHDON NORMALISHT F. 9

#### MË 3 DHE 4 DHJETOR MBAHET PANAIRI I AGROBIZNESIT 'PRISHTINA 2018' F. 9

### KULTURË

#### SHQIPËRIA NË SYTË E MPREHTË TË FAIK KONICËS F. 13

Bujar MEHOLLI

### SPORT

#### SHOTI I EVROPIANIT NUK KURSEN KOSOVËN DHE SHQIPËRINË F. 16



FLET PËR "EPOKËN E RE", HAKI SHATRI | FAQE 8-9

## Taksa 100 përqind mbetet në fuqi derisa Serbia ta ndryshojë qasjen ndaj Kosovës



Haki Shatri, këshilltar për ekonomi i kryeministrit Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se vendimi i Qeverisë së Kosovës për taksë 100 përqind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës do të mbetet në fuqi derisa këto dy shtete ta ndryshojnë qasjen ndaj Kosovës. Në këtë inter-

vistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Shatri u është përgjigjur edhe deklaratave të faktorit ndërkombëtar për ta shfuqizuar këtë vendim. Ai thotë se faktori ndërkombëtar duhet të jetë objektiv dhe i paanshëm. Sipas Shatrit, vendimet e CEFTA-s dhe të MSA-së janë shkelur vazhdimisht nga

Serbia. Këshilltari i kryeministrit Haradinaj ka thënë se taksa 100 përqind do të hiqet kur Serbia ta njohë Kosovën shtet sovran dhe të pavarur. Në këtë intervistë Shatri ka folur edhe për zhvillimet ekonomike në vend dhe për qasjen e Qeverisë për zgjidhjen e pengesave ekonomike

## Ushtria votohet më 14 dhjetor

FAQE 3



Kryesia e Kuvendit sot (e hënë) do të vendosë për datën e mbajtjes së seancës plenare për formimin e ushtrisë. Një burim brenda Kuvendit të Kosovës i ka thënë

gazetës "Epoka e re" se seanca për votim në lexim të dytë të pakos së projektligjeve për transformim të FSK-së në ushtri pritet të mbahet më 14 dhjetor



#### Behxhet Shala: Dorëheqja e kryetarëve në veri, shantazh ndaj institucioneve të Kosovës | FAQE 4-5

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Fleckenstein: Negociatat për Shqipërinë të hapen në qershor

TIRANË, 2 DHJETOR - Nëse Shqipërisë në qershor 2019 nuk do t'i hapen negociatat e anëtarësimit, sipas raportuesit për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Knut Fleckenstein, do të kishte jo vetëm pasoja negative për rajonin, por institucionet e BE-së do ta humbasin besueshmërinë. Fleckenstein thotë se me raportin që hartoi për ecurinë e reformave në

Shqipëri, e që mori miratimin e Parlamentit Evropian javën e shkuar, kërkohej t'i përcillej një mesazh Këshilli të Ministrave të BE-së. "Mesazhi kyç për Shqipërinë është: Vazhdoni kështu, por ka disa pika ku ne do të donim të shihnim më shumë rezultate. Por ishte një mesazh drejtuar Këshillit të Ministrave, që ne i mbahemi vendimit tonë dhe mbështesim Komisionin

Evropian për hapjen e negociatave dhe kërkojmë që ato të hapen vitin e ardhshëm. Nëse kjo nuk ndodh, nuk do të ketë rrjedhoja negative vetëm për rajonin, por edhe për institucionet evropiane. Nëse ato nuk janë të besueshme, atëherë harrojmë ato", u shpreh Fleckenstein. Për sa i përket sistemit të drejtësisë dhe vendeve vakante, raportuesi për

Shqipërinë u shpreh se procesi i vetingut për prokurorët dhe gjyqtarët duhet të vijojë, si dhe të plotësohen vendet vakante në këtë sistem. "E kuptoj se është një situatë e vështirë, por kjo mund të ndodhë në një fazë të tillë transitore. Problemet nuk mund të zgjidhen të gjitha njëkohësisht. Duhet pak durim për këtë. Është absolutisht e nevojshme që



gjykatat dhe prokuroritë të funksionojnë dhe që këto poste të zbrazëta të mbushen", tha Fleckensteini.

## Hahn sot arrin në Prishtinë, takon liderët institucionalë

Komisari evropian i Zgjerimit, Johannes Hahn, gjatë vizitës në Prishtinë do ta takojë presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, kryeparlamentarin Kadri Veseli dhe kryeministrin Ramush Haradinaj. Temë kryesore e bisedimeve pritet të jetë vendimi i Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksave ndaj mallrave me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Komisar i Zgjerimit i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, sot (e hënë) do të arrijë për vizitë zyrtare në Prishtinë, me ç'rast pritet të takohet me presidentin Hashim Thaçi, kryeparlamentarin Kadri Veseli si dhe kryeministrin Ramush Haradinaj. Tema kryesore e bisedimeve të komisarit Hahn në Prishtinë pritet të jetë vendimi i Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksave qind për qind ndaj mallrave me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. "Komisari Hahn do ta përsërisë qëndrimin e Bashkimit Evropian, do të bëjë thirrje për heqjen e këtyre masave dhe do të fokusohet në përmirësimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimit rajonal, parime këto të cilat Kosova dhe të gjithë partnerët nga Ballkani Perëndimor i kanë pranuar", kanë thënë në Komisionin Evropian.

Në Komisionin Evropian kanë paralajmëruar se Hahn në Kosovë do të takohet me liderët institucionalë, presidentin Hashim Thaçi, kryeparlamen-

tarin Kadri Veseli, kryeministrin Ramush Haradinaj, si dhe me përfaqësues të opozitës. Më herët, zëdhënësja e BE-së, Maja Kocijançiq, ka konfirmuar se për shkak të masave të vendosura nga Qeveria e Kosovës, Johannes Hahn, është në kontakt me liderët në Prishtinë dhe Beograd dhe se po bisedohet për qetësimin urgjent të situatës dhe uljen e tensioneve.

Të dielën është konfirmuar se kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, të hënë në orën 14:00 do të takohet me komisionarin për zgjerim dhe fqinjësi të Bashkimit Evropian, Johannes Hahn. Ky takim do të mbahet në kabinetin e kryeparlamentarit Veseli, ndërsa mediet mund të marrin pamje në fillim të takimit.

### Lista Serbe është mbyllur në Kuvend në pritje të komisionarit Hahn

Ndërkaq deputetët e Listës Serbe janë mbyllur në Kuvendin e Kosovës duke kërkuar një takim me komisionarin evropian për



zgjerim dhe fqinjësi, Johannes Hahn, i cili sot (hënë) pritet ta vizitojë Prishtinën. Në një komunikatë të Listës Serbe, është thënë se deputetët e kësaj liste kërkojnë takim me komisionarin Hahn, në mënyrë që ta njoftojnë atë me krizën humanitare e cila "e kërcënon popullin serb për shkak të vendimit të Prishtinës që ta vendosë taksën prej 100 % ndaj produkteve serbe dhe me këtë praktikisht e bllokon shpërndarjen e ushqimit, barnave, shtypit dhe produkteve tjera të nevojshme".

Lajmin e ka konfirmuar kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiq, pas mbledhjes së Shtabit të krizës në Mitrovicën Veriore, në një konferencë të jashtëzakonshme me gazetarë. "Si përfaqësues politikë legjitimë të popullit serb, ata (deputetët) dëshirojnë që komisionarin Hahn t'i tregojnë për veprimet antiserbe të Prishtinës përmes të cilave nxitet kriza humanitare e drejtuar kundër serbëve në hapësirat e Kosovës", ka thënë Rakiq, duke shtuar se deputetët po bëjnë luftë në mënyrë paqësore dhe

demokratike, në mënyrë, siç ka thënë ai, që fëmijët e tyre të kenë të drejtën për jetesë, për mjekim dhe për ardhmëri.

Nga ana tjetër, mediet serbe kanë njoftuar të dielën se Komisar i Zgjerimit, Johannes Hahn, para se të vijë në Prishtinë do të qëndrojë në Beograd për të biseduar me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Diçka të tillë nuk ka paralajmëruar komisar Hahn, madje nuk e ka as në agjendën e tij që është publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Evropian.

## Republikanët i kërkojnë Bashës t'i japë fund bojkotit parlamentar

TIRANË, 2 DHJETOR - Me ngushtimin e afatit kohor për djegien e mandateve, republikanët ishin të parët të cilët i kërkuan Lulzim Bashës ta thyejë bojkotin. Nga

Asambleja e partisë, Fatmir Mediu i kërkoi liderësit demokrat të reflektojë për qëndrimet që opozita duhet të mbajë me Parlamentin. Me zgjedhjet elektorale në prag

për republikanët, bashkimi i së djathtës është i rëndësishëm, ndërsa sa i takon përzgjedhjes së kandidatëve për kryebashkiak, Mediu kërkon që procesi të mos jetë i

njëanshëm. Republikanët këmbëngulin në ndryshimin e sistemit zgjedhor, duke mbështetur idenë e një sistemi proporcional me lista të hapura.



Komisionet parlamentare i kanë përfunduar procedurat për pakon e ligjeve për transformimin e FSK-së

# Ushtria votohet më 14 dhjetor

Kryesia e Kuvendit javën e ardhshme (të hënën) do të vendosë për datën e mbajtjes së seancës plenare për formimin e ushtrisë. Një burim brenda Kuvendit të Kosovës i ka thënë gazetës "Epoka e re" se seanca për votim në lexim të dytë të pakos së projektligjeve për transformim të FSK-së në ushtri pritet të mbahet më 14 dhjetor

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Kryesia e Kuvendit të Kosovës javën e ardhshme, të hënën, do të vendosë për datën se kur do të mbahet seanca plenare, në të cilën do të votohen tri projektligjet për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Një burim brenda Kuvendit i ka treguar gazetës "Epoka e re" se pritet që kjo seancë të mbahet më 14 dhjetor. "Sipas të gjitha gjasave, seanca për votim të dytë të tri projektligjeve për formimin e ushtrisë do të mbahet në javën e dytë të dhjetorit, më 14 dhjetor", ka thënë ky burim në

kushte anonimiteti.

Për kohën e mbajtjes së kësaj seance një ditë më parë ka folur edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Teksa kishte përfunduar një stadium të enjten në Skenderaj, Veseli ka thënë se kjo seancë do të mbahet në mes të dhjetorit. "Këtë vit ne do të kemi një ushtri të Kosovës. Në mes të dhjetorit do të votojmë për formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Të hënën do të kemi një takim të Kryesisë së Kuvendit, pastaj do ta caktojmë një datë. Në këtë mënyrë do t'i ndjekim të gjitha procedurat. Komisionet parlamentare janë në fund të punës për këtë çështje. Vendimi për ushtrinë është si

një borxh për viktimat e popullit tonë, një dëshirë për liri dhe paqe në të ardhmen", ka thënë Veseli. Ai ka treguar se ky vendim do të bëhet në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj. "Njerëzit tanë nuk kanë qenë agresivë ndaj askujt, as nuk do të jenë. Kosova është shtet i pavarur dhe sovran dhe gjithmonë do të jetë i tillë", ka vlerësuar kryeparlamentari.

Ndërsa Komisioni për Buxhet dhe Financa të premtën ka miratuar tri projektligjet për transformimin e FSK-së: Projektligjin për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me amendamente të komisionit funksional. Anëtarët e këtij komisioni këtë pako të ligjeve e kanë votuar në mënyrë anonime, duke vlerësuar se këto projektligjet janë ndër projektligjet më të rëndësishëm për të ardhmen e vendit.

Kryetari i këtij komisioni, Lumir

Abdixhiku, ka thënë se, pavarësisht prej transformimit të FSK-së, nuk po mendohet për rritje të buxhetit për ushtrinë, ndërsa vetëm 0.7 për qind shkon për mbrojtje. Sipas deputetit të LDK-së, ekziston mundësia buxhetore për ta financuar ushtrinë, duke ulur shpenzimet publike në gjëra të panevojshme. "Jemi këtu në mbledhje të jashtëzakonshme. Kosova shpenzon vetëm 0.7 për qind të brutoproduktit për mbrojtje. Ushtria e Kosovës këtë vit do të ketë buxhet 53 milionë euro, në vitin 2020 do të ketë 57 milionë dhe në vitin 2021 do të ketë 62 milionë euro", ka deklaruar Abdixhiku.

Kurse nënkryetarja e këtij komisioni, deputetja e PDK-së, Safete Hadergjonaj, ka deklaruar se menjëherë pas votimit në parim të këtyre projektligjeve duhet të ketë iniciativa që të bëhen ligje dhe Kuvendi t'i votojë si të tilla. Sipas saj, nuk do të ketë problem për çështjet financiare.

Edhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosjeje, Ali Lajçi, i ka

dhënë përkrahje pakos së projektligjeve për FSK-në. "Ka edhe mangësi sepse trajtohen në bazë të Ligjit për FSK-në. Çdo tentim të dinamizimit dhe përparimit të FSK-së drejt një misioni ushtarak e përkrah fuqimisht. Miratimi i ligjeve pa një kosto financiare është pak problematik", ka theksuar Lajçi. Ndërsa deputeti i Nismës Socialdemokrate, Enver Hoti, ka deklaruar se është domosdoshmëri miratimi i këtyre projektligjeve. Sipas tij, Kosovën nuk e kanë penguar mjetet financiare për ta bërë këtë transformim të FSK-së në ushtri. Gjatë ditës këto tri projektligje janë votuar edhe në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim. Në leximin të parë kjo pako e projektligjeve kishte marrë mbështetje të fuqishme parlamentare. Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes kishte marrë 101 vota, ai për Forcën e Sigurisë së Kosovës 98, kurse Projektligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës 96 vota.



## LB-ja nderon dëshmorët Hyzri Talla, Ilir Durmishi dhe Afrim Maliqi

PRISHTINË, 2 DHJETOR (ER) - Me rastin e 20-vjetorit të rënies së dëshmorëve Hyzri Talla, Ilir Durmishi dhe Afrim Maliqi, udhëheqja e Lëvizjes për Bashkim (LB) ka bërë homazhe të dielën pranë varreve të këtyre dëshmoreve të UÇK-së. Kryetari

i LB-së, Valon Murati, ka shkruar në profilin e vet në "Facebook" se në historinë e luftës çlirimtare lart do të qëndrojnë emrat e Hyzriut dhe bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë. "Sot nderuam dëshmorët e shokët tanë, Hyzri Tallën, Ilir Durmishin dhe Afrim

Maliqin. Në historinë e luftës sonë çlirimtare të LKÇK-së e të UÇK-së lart do të qëndrojnë emri i Hyzriut, një prej figurave qendrore të organizimit të luftës çlirimtare jo vetëm në Zonën Operative të Llapit, por edhe në atë të Shalës e të Karadakut dhe

bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë, që deri në ditën kur ranë heroikisht, ishin në shërbim të organizimit e luftës çlirimtare Ilir Durmishit dhe Afrim Maliqit. Eltës, Elsës dhe Bardhit sot më shumë se t'i ngushëllojmë u themi se duhet

të qëndrojnë të fortë e krenarë për baballarët e tyre, të cilët me mungesën e tyre çdo ditë na dëshmojnë se sa e shtrenjtë është liria që e kemi sot. Nderim i përjetshëm për Hysin, Ilirin dhe Afrimin", ka shkruar Murati.

Flet për "Epokën e re", Behxhet Shala

# Dorëheqja e kryetarëve në veri, shan



Njohësi i proceseve politike në vend, Behxhet Shala, ka thënë se zhvillimet e fundit në veri të vendit nuk kanë lidhje me vendosjen e taksës prej 100-përqindësh ndaj produkteve të Serbisë. Ai ka vlerësuar se taksë është vetëm një arsytim për ta përligjur gjendjen që ekziston në veri që nga viti 1999. Sipas Shalës, dorëheqja e kryetarëve të komunave në veri është shantazh ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Shala ka theksuar se institucionet e Kosovës duhet të jenë më të vendosura karshi ngjarjeve në veri, duke respektuar Kushtetutën dhe duke mos lëshuar më pe ndaj atyre që në asnjë mënyrë nuk e pranojnë Kosovën shtet

sepse nuk mund të bëjnë asgjë. Edhe ndërkombëtarët po heshtin për zhvillimet në veri. Zhvillimet në veri kanë karakter shantazhues dhe kanë për qëllim tensionimin e situatës", është shprehur Shala.

Ai ka vlerësuar se ngjarjet në veri nuk kanë lidhje me vendosjen e taksës prej 100 përqindësh ndaj produkteve të Serbisë. Sipas Shalës, taksë është vetëm një arsytim për ta përligjur gjendjen që ekziston në veri që nga viti 1999. Sidoqoftë, ai ka thënë se institucionet e Kosovës duhet të jenë më të vendosura karshi këtyre ngjarjeve, duke respektuar Kushtetutën dhe duke mos lëshuar më pe ndaj atyre që në asnjë mënyrë nuk e pranojnë Kosovën shtet.

Shala nuk e ka hedhur poshtë mundësinë që për shkak të presionit të madh Kosova të heqë dorë nga taksë, megjithatë ai ka thënë se kjo çështje nuk mund ta rrezikojë funksionimin e

koalicionit qeverisës. Ai ka thënë se aktualisht është e nevojshme që një parti shqiptare të hyjë në koalicion me partitë që janë në pushtet, në mënyrë që ta nxjerrë nga loja Listën Serbe dhe që vendi mos të shkojë në krizë.

**"Epoka e re":** Z. Shala, si i komentoni zhvillimet e fundit në veri të vendit, përkatësisht dorëheqjen e katër kryetarëve të komunave në këtë pjesë? Pse kemi një heshtje të institucioneve të Kosovës?

**Shala:** Serbët në Kosovë bëjnë çfarë të duan. Ata janë qind për qind nën kontroll të Beogradit. Dorëheqja e katër kryetarëve të komunave në veri është shantazh ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës. Drejtuesit e institucioneve të Kosovës po heshtin sepse nuk mund të bëjnë asgjë. Mund edhe t'i shpallin zgjedhjet, por KQZ-ja është joaktive. Po edhe nëse do të mbaheshin zgjed-

hjet, serbët nuk do të dilnin kundër vullnetit të Beogradit. Edhe ndërkombëtarët po heshtin për zhvillimet në veri. Në njërin anë ata po bëjnë presion te kryeministri Haradinaj që të lëshojë pe për taksën prej 100-përqindësh për produktet serbe, ndërkajë aspak nuk po brengosen për zhvillimet dhe dorëheqjet në veri. Kemi poteza të padijshme në politikë. Agim Bahtiri e mori iniciativën për bashkimin e Mitrovicës, që është e pamundur të ndodhë. Zhvillimet në veri kanë karakter shantazhues dhe kanë për qëllim tensionimin e situatës.

**"Epoka e re":** Do të mund të sjellë pasoja një veprim i tillë. Dhe, nëse mund të jetë ky një tentim për shkëputjen e plotë të veriut nga administrimi i shtetit të Kosovës?

**Shala:** Në vazhdimësi pjesëmarrja e serbëve në institucionet qendrore të Kosovës

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Analisti politik Behxhet Shala ka thënë të premten se dorëheqja e kryetarëve të komunave në veri është shantazh ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e

re", ai ka theksuar se këto zhvillime kanë për qëllim tensionimin e situatës. "Serbët në Kosovë bëjnë çfarë të duan. Ata janë qind për qind nën kontroll të Beogradit. Dorëheqja e katër kryetarëve të komunave në veri është shantazh ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës. Drejtuesit e institucioneve të Kosovës po heshtin

# tazh ndaj institucioneve të Kosovës

Republikës së Kosovës. Duhet t'u bëhet me dije ndërkombëtarëve se Kosova është shtet i pranuar nga 115 shtete me kufijtë ekzistues dhe se nuk duhet të vijë në shprehje asnjë zgjidhje që e prek qoftë një centimetër të territorit të Kosovës. Në të kundërtën, do të ketë eskalim të situatës dhe pasojat do të jenë të mëdha. Loja me korrigjimin e kufijve nuk do të përfundonte vetëm në veri, por do t'i prekte të gjitha vendet ku ka shqiptarë.

**"Epoka e re": Kryetarët serbë i kanë arsyetuar dorëheqjet me vendosjen e taksës prej 100 përqindësh ndaj produkteve serbe. Duke e pasur parasysh presionin e serbëve në Kosovë, të Serbisë si dhe të bashkësisë ndërkombëtare, a besoni se Kosova do të mund ta përballojë këtë presion dhe ta mbajë edhe gjatë këtë masë në fuqi?**

**Shala:** Taksa ndaj produkteve

serbe nuk ka lidhje me dorëheqjen e kryetarëve të komunave në veri. Taksa është vetëm një arsyetim për ta përligjur gjendjen që ekziston në veri që nga viti 1999. Çdo shtet vendos taksa ndaj një shteti të caktuar, por kjo nuk do të thotë të ndahet një pjesë e territorit të atij vendi. Askush nuk mund të na detyrojë që të blejmë mallra nga Serbia dhe Bosnja. Taksa edhe mund të hiqet sepse presioni është shumë i madh, mirëpo askush nuk mund të na detyrojë, madje as BE-ja të blejmë mallra të një vendi që ka bërë gjenocid në Kosovë. Edhe nëse hiqet taksa, qytetarët e Kosovës duhet të jenë të vendosur për të mos blerë asnjë produkt të Serbisë përderisa serbët e Kosovës nuk sillen në përputhje me ligjin. Kryeministri Haradinaj duket se e ka përkrahjen unanime të qytetarëve, por e ka një kundërshtim të heshtur nga presidenti Thaçi, i cili më shumë

e kundërshton për shkak të idesë për korrigjim të kufirit sesa për taksën.

**"Epoka e re": Ndonëse kryeministri Haradinaj ka paralajmëruar se kjo masë do të mbetet në fuqi deri në njohjen e Kosovës nga Serbia, a mund të jetë kjo një arsye për prishje të koalicionit qeverisës?**

**Shala:** Nëse Haradinaj lëshon për taksën do të humbë politikisht sepse vendimi për taksën ndaj produkteve serbe shkon në dobi të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Realisht nuk mendoj se për shkak të taksës mund të prishet koalicioni. Më shumë ka rrezik që koalicioni të prishet për shkak të lojës për kufijtë në prapaskenë nga presidenti Thaçi. Edhe po të prishej koalicioni, fituesi më i madh do të ishte Haradinaj, kurse humbësi do të ishte Thaçi. Është brenësore loja dyfytërshe që po e luan LDK-ja, duke keqpërdorur

ar gjendjen në Kosovë për të shkuar në zgjedhje. Sipas mendimit tim, aktualisht është e nevojshme që një parti shqiptare të hyjë në koalicion me partitë që janë në pushtet në mënyrë që ta nxjerrë nga loja Listën Serbe dhe që vendi mos të shkojë në krizë.

**"Epoka e re": Z. Shala, si e shihni vazhdimin e procesit të dialogut pas këtyre zhvillimeve?**

**Shala:** Dialogu është i përcaktuar nga të tjerët dhe Thaçi është një lojtar fatkeq i cili, sipas mendimit tim, po i sjell dëm Kosovës, kurse Vuçiqi është fitues absolut. Kosova, nëse e humb edhe një metër të territorit, është humbëse, sepse deri më tani ka bërë shumë lëshime dhe shumë gabime që nga përfundimi i luftës. Mirëpo Ballkani nuk duron zgjidhje parciale sepse zgjidhjet e tilla mund të shkaktojnë kriza të reja dhe luftë.

## KDI-ja nis aktivitetet në kuadër të muajit kundër korrupsionit

**PRISHTINË 2 DHJETOR (ER)** - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka nisur të dielën aktivitetet e para që do të zhvillohen në kuadër të muajit kundër korrupsionit 2018, në një bashkëbisedim me përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile. Me këtë rast, drejtori ekzekutiv i KDI-së, Ismet Kryeziu, ka theksuar se në këtë vit KDI-ja do ta vendosë qytetarin e zakonshëm në plan të parë. "Këto aktivitete kanë për qëllim ta fuqizojnë rolin e qytetarit si aktor i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit dhe përkojnë me përpjekjet globale qytetare për një 'botë të lirë nga korrupsioni'", ka thënë ai.

Ndërkaq Florent Spahija, zyrtar ligjor në KDI, ka theksuar se në prag të ditës ndërkombëtare kundër korrupsionit, 9 Dhjetor, Kosova në rrafshin ndërkombëtar dhe atë vendor vazhdon të asocohet ngushtë me joefikasitet në luftën kundër korrupsionit. "Secila aspiratë për të avancuar agjendën e integritetit evropiane dhe zhvillimin ekonomik është e kushtëzuar me rezultate konkrete në luftimin e korrupsionit. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit nga Transparency International për vitin 2017 e radhitë Kosovën në vendin e 85-të me 39 pikë, larg nga mesatarja globale prej 43 pikësh", ka pohuar ai.

Spahija ka thënë se KDI po e nis shënimin e muajit kundër korrupsionit me mesazhe dhe inkurajim për qytetarët që të flasin dhe raportojnë korrupsionin dhe të kërkojnë llogari çdo ditë nga institucionet dhe të zgjedhurit e tyre për rezultate konkrete. "Gjatë këtij muaji do të shpallen fituesit e garës së fotografisë dhe videos më të mirë të realizuar nga qytetarët, ku paraqiten efektet që korrupsioni ka në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Pjesë e pandashme e punës sonë çdo ditë është dhënia e këshillave ligjore

pa pagesë për qytetarët që duan ta raportojnë korrupsionin, sinjalizuesit e korrupsionit dhe dëshmitarët e korrupsionit. Për tre vjet punë të dhënies së këshillave ligjore kemi pranuar mbi 300 raste të ndryshme të korrupsionit", shtoi ai. Gjatë këtij muaji, KDI-ja do të bëjë publike raporte që flasin për cilësinë e prokurimit në institucionet qeveritare, që janë edhe ndër shpenzuesit më të mëdhenj të parasë publike, si: Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Shëndetësisë dhe Autoriteti Qendror i Prokurimit.

Në kuadër të kësaj do të shpalojë një analizë e vendimit të qeverisë për dhënien e 53 milionë eurove si penalti kompanisë "Bechtel & Enka" si dhe një analizë tjetër që flet për mosndëshkueshmërinë në prokurimin publik. Po ashtu, KDI-ja gjatë këtij muaji do ta trajtojë edhe financimin e subjekteve politike në kohë të fushatave elektorale, më saktë nëpërmjet një analize ligjore do t'i promovojë standardet e reja të transparencës në fushata zgjedhore, standarde që përdoren edhe në vendet e BE-së.

ka qenë formale. Ata vetëm kanë përfituar nga buxheti i shtetit, ndërsa i bindën Serbisë. Deri më tani me asnjë veprim nuk kanë treguar se duan të integrohen në institucionet e Republikës së Kosovës. Gjithmonë ata kanë përçarur porosinë nga Beogradi dhe kjo vetëm e ka mbuluar ndarjen faktike me një cipë të hollë, e cila nuk ka mbuluar asgjë. Lisa Serbe është mjet shantazhi përmes së cilës Beogradi e destabilizon Kosovën për ta kushtëzuar BE-në që të jetë më dorëlirë karshi Serbisë. Institucionet e Kosovës duhet të jenë më të vendosura karshi zhvillimeve në veri. Duhet ta respektojnë Kushtetutën dhe të mos lëshojnë më pe ndaj atyre që në asnjë mënyrë nuk e pranojnë Kosovën si shtet.

**"Epoka e re": Si e shihni zgjidhjen e kësaj çështje?**

**Shala:** Zgjidhja e kësaj çështje është zbatimi i Kushtetutës së

INSTITUTI  
DEMOKRATIK  
I KOSOVËS

25  
TRANSPARENCY  
INTERNATIONAL  
the global coalition against corruption

# #fajikorrupsionit

MUAJI KUNDËR  
KORRUPSIONIT

Embassy  
of the Federal Republic of Germany  
Prishtine

German  
Cooperation  
with the Government

# KCSF-ja: Shoqëria civile mbetet faktor i rëndësishëm për demokratizimin e vendit

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ka publikuar Indeksën Kosovare të Shoqërisë Civile 2018. Ky studim tregon se, pavarësisht prej situatës së vështirë politike dhe ekonomike në Kosovë, shoqëria civile ka arritur të mbetet faktor shumë i rëndësishëm për demokratizimin e vendit. "Më shumë qytetarë janë angazhuar në shoqëri civile krahasuar me të kaluarën, qoftë si anëtarë apo duke bërë punë vullnetare. Për shumë vjet me radhë tashmë shoqëria civile vazhdon të jetë ndër sektorët më të besueshëm në Kosovë, së bashku me institucionet e sigurisë. Megjithatë, në përgjithësi apatia qytetare vazhdon dhe numri i

atyre që angazhohen në këtë sektor mbetet i ulët, ndërsa shoqëria civile nuk po arrin të komunikojë e përfshijë sa duhet qytetarët në punën e vet", është thënë në komunikatën e KCSF-së. Në anën tjetër thuhet se krizat e njëpasnjëshme politike dhe polarizimi i skajshëm i skenës politike në Kosovë, së bashku me fokusin e plotë të institucioneve kryesore në tema madhore si demarkacioni ose dialogu me Serbinë, duket se kanë ndikuar edhe në shoqërinë civile. Angazhimi i këtij sektori në politika publike ka rënë dukshëm qoftë në raport me ftesat nga institucionet publike apo me nisimat e vet sektorit. Në përgjithësi, organizatat e konsoliduara vazhdojnë të jenë aktive edhe në politikëbërje, por një pjesë shumë e madhe e sektorit nuk përfshihet

në këtë proces as në nivelin lokal as në atë qendror. "Trendi i financimit në shoqëri civile është në rënie në krahasim me dy vjet më parë, në të gjithë indikatorët që e mbulojnë këtë fushë, përveç fondeve publike. Gati gjysma e organizatave aktive nuk kanë fonde aspak, ndërsa në çerekut tjetër kanë qarkullim vjetor shumë të ulët, vetëm disa mijëra euro në vit. Këto përqindje janë përkeqësuar në raport me dy vjet më parë", është theksuar në këtë komunikatë. Sipas KCSF-së, donatorët e huaj vazhdojnë të jenë burimi kryesor i financimit, edhe pse fondet e tyre u ndahen një numri më të vogël të organizatave krahasuar me dy vjet më parë. Në anën tjetër, është rritur financimi nga fondet publike, sidomos numri i organizatave që kanë përfituar fonde nga institu-

cionet publike.

Edhe pse opinioni publik shoqërinë civile kryesisht e identifikon nëpërmjet organizatave të mëdha dhe me shumë fonde e të punësuar, studimi tregon se një numër i madh i organizatave punojnë në baza tërësisht vullnetare, ndërsa numri i vullnetarëve të angazhuar në sektor është disafish më i lartë se numri i të punësuarve.

Indeksi Kosovar për Shoqëri Civile 2018 identifikon edhe problemet me të cilat ballafaqohet sektori, disa prej të cilave janë zvogëlimi i fondeve të huaja për organizata të shoqërisë civile, por edhe mungesa e transparencës së mjaftueshme të ndarjes së fondeve publike; mungesa e mekanizmave funksionale për lehtësira tatimore për OShC; dominimi i financimit për

projekte afatshkurta, rrjedhimisht pamundësia e planifikimit për një kohë më të gjatë dhe intervenime më komplekse e strategjike; koncentrimi i madh i organizatave të shoqërisë civile në Prishtinë dhe qendra të tjera të mëdha urbane në Kosovë etj. Gati gjysma e OShC-ve në Kosovë veprojnë pa fonde fare (46 për qin), derisa pjesa më e madhe e OShC-ve operojnë me më pak se 10 000 euro në vit (23 për qind). Përkundër që shumica e OShC-ve kanë pak ose aspak fonde dhe numër të vogël të të punësuarve, megjithatë shoqëria civile punëson në radhët e veta një numër të konsiderueshëm të stafit. Donatorët e huaj vazhdojnë të jenë financuesit kryesorë të shoqërisë civile, me rënie të dukshme krahasuar me vitin e kaluar.

## Kryesia e LDK-së përkujton Ibrahim Rugovën

PRISHTINË, 2 DHJETOR (ER) - Në 74-vjetorin e lindjes së ish-presidentit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, kryesia e LDK-së, bashkë me miq dhe bashkëpunëtorë, të dielën kanë bërë homazhe te varri i tij. Në emër të kryesisë së LDK-së ka folur nënkryetari i LDK-së, Agim Veliu. Ai ka vlerësuar lart figurën e Rugovës dhe në këtë ditëlindje të tij ka theksuar tipare të karakterit të tij si burrërinë, vendosmërinë dhe diplomacinë e urtësinë e tij me të cilat e bëri

për vete popullin e Kosovës dhe gjithë botën. "Rugova ishte presidenti i parë i Kosovës, i cili ëndërrat shekullore të popullit për liri, pavarësi e demokraci i projektoi bukur dhe i udhëhoqi deri në realizimin e tyre. Ibrahim Rugova ishte arkitekt i pavarësisë së Kosovës", ka thënë Veliu. Kryesia e LDK-së, pas homazheve, ka vizituar edhe familjen Rugova. Në emër të kryesisë së LDK-së ka folur sekretari i përgjithshëm, Ismet Beqiri, i cili ka vlerësuar lart

punën, jetën dhe veprën e presidentit Rugova. Beqiri ka theksuar mungesën që ka lënë Rugova pas vdekjes, sidomos në sfidat e sotme në të cilat po kalon vendi. Fana Rugova ka falënderuar kryesinë e LDK-së për vizitën dhe ka falënderuar LDK-në për punën që është duke e bërë, partinë të cilën e themeloi presidenti Rugova. Ish-presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova, ka lindur më 2 dhjetor 1944 dhe ka vdekur më 21 janar 2006.



Partia Socialdemokrate po synon ta përfshijë në dialogun me Serbinë gjithë opozitën

## LDK-ja dhe LV-ja kundër propozimit të PSD-së për dialogun

Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje nuk do ta përkrahin propozimin e ri të PSD-së, i cili synon që delegacioni i Kosovës në bisedimet me Serbinë të drejtohet nga një përfaqësues i pozitës dhe një i opozitës. Partia e Isa Mustafës dhe ajo e Albin Kurtit mendojnë se fillimisht Kosova duhet të shkojë në zgjedhje të reja

EPOKA  
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Partia Socialdemokrate ka dërguar në Kuvendin e Kosovës një projekt-rezolutë nëpërmjet së cilës synon që opozitës t'ia japë gjysmën e përgjegjësisë në procesin e dialogut me Serbinë. Mirëpo Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje nuk do ta përkrahin propozimin e PSD-së. Kjo e fundit ka kërkuar që delegacioni i Kosovës për bisedime me Serbinë të drejtohet nga një përfaqësues i pozitës dhe një i opozitës. "Delegacioni shtetëror do të bashkëdrejtohet barabarësisht prej (dy) përfaqësuesve që vijnë nga radhët e opozitës parlamentare dhe nga koalicioni qeveritar. Një përfaqësues nga shoqëria civile do të jetë anëtar i rregullt i delegacionit shtetëror", është thënë në propozimin e PSD-së.

Ky propozim nuk u ka pëlqyer dy partive të tjera opozitare, LDK-së dhe LV-së.

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, është deklaruar kundër projekt-rezolutës të PSD-së. Ai ka thënë se ky subjekt politik fillimisht duhet t'i verifikojë mandatet në zgjedhje. "Vetëm zgjedhjet e reja sigurojnë legjitimitetin e atyre që e udhëheqin Kosovën dhe që do ta përfaqësojnë dialogun. Kjo vlen edhe për PSD-në para se të bëhet pjesë e çfarëdo ekipi negocues. PSD-ja duhet përmes zgjedhjeve të reja të verifikojë 12 mandatet që ka në Kuvend, ngaqë janë mandate të fituara nga një parti tjetër. Vlerësoj se verifikimi i legjitimitetit është i domosdoshëm për qëndrueshmërinë e demokracisë në Kosovë dhe të PSD-së, gjithashtu", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe nënkryetari i LDK-së, Agim Veliu, ka deklaruar të dielën se kjo parti parapëlqen

që së pari të shkohet në zgjedhje, pastaj të diskutohet për fazën finale të dialogut me Serbinë. "Kjo është për keqardhje sepse institucionet e Kosovës nuk janë duke e kryer punën e vet për çka janë të zgjedhura. Këto përplasje janë jashtëzakonisht të dëmshme për Kosovën dhe për përpjekjet e popullit shqiptar që të integrohet ashtu siç i ka synimet dhe ashtu siç na ka trasuar rrugën presidenti Rugova. Këto institucione e kanë humbur legjitimitetin dhe kredibilitetin

për ta drejtuar vendin dhe sa më shpejt është më mirë që Kosova të lirohet nga institucione të tilla", ka thënë Veliu të dielën pas homazheve që ka bërë te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova. Ndërsa deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Sami Kurteshi, ka thënë se rezolutat e Kuvendit të Kosovës nuk po zbatohen. Sipas tij, për këtë subjekt politik dialogu Kosovë - Serbi nuk është punë vetëm e një rezolute. Deri më tani, pavarësisht disa përpjekjeve, pozita dhe opozita

nuk kanë arritur të gjejnë një kompromis për dialogun me Serbinë. As Qeveria nuk ka mundur t'i marrë votat e nevojshme për miratimin në Kuvend të delegacionit qeveritar për bisedime dhe as opozita nuk ka arritur ta miratojë projekt-rezolutën e propozuar nga LDK-ja dhe LV-ja përmes së cilës synohet t'i ndalohet presidentit të vendit, që në bisedimet me homologun e tij serb, të bisedojë për korrigjim të kufirit në mes të dy shteteve.

## LV-ja: Viktimat e dhunës s'mund të mbesin në mëshirën e pushtetit të burrave

Zyrtarët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) kanë kërkuar nga shteti t'i mbështetë më shumë strehimoret e viktimave të dhunës. Drejtuesja e Sekretariatit të Gruas në Lëvizjen Vetëvendosje, Nazlie Bala, dhe deputeti i kësaj partie, Sami Kurteshi, kanë vlerësuar të dielën se strehimoret kanë probleme të shumta financiare



PRISHTINË, 2 DHJETOR (ER) - Drejtuesja e Sekretariatit të Gruas në Lëvizjen Vetëvendosje, Nazlie Bala, ka thënë të dielën se viktimat e dhunës nuk mund të mbesin në mëshirën e pushtetit të burrave të korruptuar. Sipas saj, strehimoret e viktimave të dhunës ballafaqohen me probleme të ndryshme e të shumta. "Shuma që shteti shpenzon në ditë për viktimat është nga 1.7 euro deri në 7.6 euro maksimalisht. Një trajtim i tillë është si formë dënimi në vend se të ishte raport kujdesi. Nganjëherë strehimoret detyrohen të pranojnë më shumë viktimat sesa kanë kapacitet", ka thënë Bala gjatë një konference për media.

Ajo ka marrë si shembull strehimoren në Gjakovë e cila ka kapacitet prej 16 shtretërve. "Në ditën kur e kemi vizituar strehimoren kanë qenë 22 viktimat, prej tyre kishte gra dhe fëmijë. Kjo strehimore qëndron më se keqi financiarisht", është shprehur ajo, duke prezantuar shifrat për secilën strehimore se sa shpenzon shteti për një viktimë. "Këto shifra flasin se shteti nuk është në anën e të dobët. Madje edhe agresori i këtyre rasteve merr më shumë kujdes prej shtetit. Disafish më shumë shteti shpenzon për të burgosurit. Kjo tregon se statusi i viktimës është i papërfillshëm në shoqërinë tonë. Një gjendje e tillë

vjen si pasojë e mosfinancimit, por vetëm subvencionimit nëpërmjet projekteve. Shuma që u ndahet strehimoreve për një vit është 20 000 euro. Nga kjo shumë, 30 për qind ndahen paga për stafin. Paga e punëtorëve të strehimoreve shkon nga 120 euro deri në 170 maksimalisht", ka deklaruar Bala. Kurse deputeti i këtij subjekti politik, Sami Kurteshi, ka vlerësuar se forma më brutale e shprehjes së

mentalitetit patriarkal dhe pushtetit të burrave të korruptuar është dhuna ndaj grave. Sipas tij, pasojë e kësaj është numri i lartë i atyre që kërkojnë strehim dhe mbrojtje. Kurteshi ka deklaruar se duhet të punohet për parandalimin e dhunës, në të njëjtën kohë të ofrohet kujdes në nivel shtetëror për viktimat. "Pavarësisht prej shifrave formale, dhuna është shumë më e madhe sesa raporti-

mi. Andaj edhe reagimi shtetëror duhet të jetë më i madh", është shprehur Kurteshi, duke shtuar se dhuna vjen si pasojë e shpërdorimit të pushtetit të burrave. "Strehimoret në nivel vendi, përveç certifikimit për shërbimet të cilat i ofrojnë, duhet të institucionalizohen dhe të zyrtarizohen ashtu që në buxhetin e shtetit ta kenë një zë buxhetor të veçantë", ka deklaruar Kurteshi.

Flet për "Epokën e re", Haki Shatri

# Taksa 100 për qind mbetet në fuqi derisa Serbia ta ndryshojë qasjen ndaj Kosovës

Haki Shatri, këshilltar për ekonomi i kryeministrit Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se vendimi i Qeverisë së Kosovës për taksë 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës do të mbetet në fuqi derisa këto dy shtete ta ndryshojnë qasjen ndaj Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Shatri u është përgjigjur edhe deklaratave të faktorit ndërkombëtar për ta shfuqizuar këtë vendim. Ai thotë se faktori ndërkombëtar duhet të jetë objektiv dhe i paanshëm. Sipas Shatrit, vendimet e CEFTA-s dhe të MSA-së janë shkelur vazhdimisht nga Serbia. Këshilltari i kryeministrit Haradinaj ka thënë se taksa 100 për qind do të hiqet kur Serbia e njeh Kosovën shtet sovran dhe të pavarur. Në këtë intervistë Shatri ka folur edhe për zhvillimet ekonomike në vend dhe qasjen që po merr Qeveria për zgjidhjen e pengesave ekonomike

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 DHJETOR -

**"Epoka e re": Z. Shatri, cili është vlerësimi juaj sa iu përket parametereve makroekonomike në vend?**

**Shatri:** Në vitin 2017 Kosova ka realizuar rritje reale të BPV-së 4.2 për qind dhe presim që viti 2018 të mbyllet me rritje reale deri 4.5 për qind. Ky shtim është stabil dhe pritjet tona për tre vjetet e ardhshëm janë më optimiste. Pra, aplikimi i politikave makroekonomike, sidomos atyre fiskale, kanë krijuar kushte për një zhvillim të qëndrueshëm dhe dinamik. Kjo dinamikë e shtimit është më e larta në regjion. Megjithatë, Qeveria nuk është e kënaqur dhe po punon për arritjen e parametereve më të lartë përgjatë mandatit vijues. Konsiderojmë se vetëm një rritje mbi 7 për qind e BPV-së mundëson zgjidhjen e problemeve në sferën e papunësisë dhe të sigurimit të mirëqenies sociale, probleme këto të pranishme. Përndryshe, të shkoqitur veç e veç, parametrat makroekonomikë janë shumë stabilë dhe premtues të arritjeve të synimeve tona zhvillimore. Ta përmendim stabilitetin makroekonomik, politikën monetare-

kreditore, shkallën e ulët të ngarkesës së ekonomisë me borxhe të brendshme dhe të jashtme, trendin në rritje të investimeve publike dhe private. Nuk qëndrojmë mirë me bilancin e këmbimit ndërkombëtar të mallrave pasi mbulimi i importit me eksport është tejtejet i ulët.

**"Epoka e re": Qeverisja Haradinaj është kritikuar për numër të lartë të zëvendësministrave dhe shpenzime enorme. A e keni në plan të projektbuxhetit reduktimin e shpenzimeve?**

**Shatri:** Një strukturë politike e nevojshme për formimin e Qeverisë, siç ishte kjo e formimit të Qeverisë Haradinaj, ka imponuar këtë vëllim të strukturës qeverisëse. Nuk mendoj se 20-30 zëvendësministra ngrehin shpenzimet në masën që ju po i quani enorme. Po të shikohet projektbuxheti për vitin 2019, shohim se kategoria e pagave dhe e mëditjeve është zvogëluar si pjesëmarrje në BPV nga 8.8 për qind në këtë vit në 8.6 për qind. Të dalat buxhetore do të rriten 12.4 për qind në vitin që vjen, kurse kategoria e pagave dhe mëditjeve do të rritet vetëm 4.4 për qind, do të thotë do të ketë zvogëlim relativ në krahasim me kategoritë e tjera

shpenzuese. Të mos harrojmë se në vitin e ardhshëm do të fillojë zbatimi i Ligjit për pagat i cili ka një kosto të ndjeshme buxhetore. Duhet theksuar se tentimi për rregullimin me Ligj të pagave ka qenë një tentim i përhershëm i të gjitha qeverive të mëparshme, por të cilat nuk arritën të nxjerrin një ligj me të cilin do të rregullohej kjo sferë mjaft e rëndësishme dhe delikate. Këtë e bëri me vendosmëri dhe guxim kryeministri Haradinaj.

**"Epoka e re": Po ashtu, sa iu përket kërkesave të organizatave buxhetore, pritjet të këtyre ndryshim?**

**Shatri:** Procesi i përgatitjes së Ligjit për buxhetin vjetor fillon që në shkurt të vitit aktual për vitin që vjen. Fillimisht u dërgohen qarkoret buxhetore të gjitha organizatave buxhetore, rifreskohet korniza afatmesme e shpenzimeve etj. Pra, gjatë kësaj periudhe organizatat buxhetore kanë kohë të mjaftueshme për parashtrimin e kërkesave të tyre. Normalisht kërkesat duhet të jenë të shoqëruara me dokumentacion përkatës si projekte investive, programe etj. Shumë herë këto kërkesa vijnë pas afatit kohor të caktuar me ligj, të paargumentuara dhe përtej

kufijve të shpenzimeve për ato organizata buxhetore. Marrë në tërësi, kërkesat janë gjithmonë disa herë më të mëdha sesa mundësitë, kufijtë e shpenzimeve. Por, edhe pas miratimit të projektligjit të buxhetit në Qeveri dhe procedimit në Kuvend vazhdojnë të arrijnë kërkesa nga organizatat buxhetore. Ato kërkesa shqyrtohen në Komisionin për Buxhet të Kuvendit dhe, nëse gjejnë përkrahje, mund të bëhen pjesë e ligjit.

**"Epoka e re": Sipas vlerësimeve të Sindikatës së Policisë së Kosovës, sigurimi i tyre kap vlerën katër milionë euro. Kjo do të hyjë në projektbuxhet?**

**Shatri:** Komponentët e sigurisë së brendshme janë shumë të rëndësishme për Qeverinë. Kryeministri Haradinaj personalisht është angazhuar për shlyerjen e obligimeve ndaj policisë së Kosovës për orët shtesë të punës, obligim ky i mbetur me muaj e vite. Por, jo vetëm kjo. Për përgatitjen e ligjit për pagat, policia e Kosovës është trajtuar me kujdes të veçantë. Në vitin 2019 do të zgjidhen edhe dy çështje të mbetura: sigurimi shëndetësor dhe pensionimi i policëve. Të dy këto çështje kërkojnë zgjidhje sistimore, sepse nuk janë

çështje të një vendimi, por duhet rregulluar me ligj dhe merr kohë për përgatitje dhe procedura të miratimit.

**"Epoka e re": Sa keni mundur si Aleancë ta inkorporoni planin tuaj qeverisëse ekonomik në kuadër të koalicionit?**

**Shatri:** Programi i AAK-së për qeverisje është një program i përgatitur nga profesionistë të fushave dhe mbështetet në nevojat dhe mundësitë e vendit. Mendoj se realizimi i një programi si është ky i AAK-së do të ishte shumë i mirë për vendin. AAK-ja, siç e dini, nuk qeveris e vetme. Në këtë proces duhet inkorporuar edhe pjesë të programeve të partnerëve të koalicionit të cilat nuk bien ndesh

## Dogana: Hyrja e mallrave komerciale në Kosovë vazhdon normalisht

Prishtinë 2 dhjetor (ER) - Dogana e Kosovës ka njoftuar të gjithë qytetarët, bizneset, OJQ-të dhe çdo palë tjetër të interesit lidhur me procedurat doganore në përputhje me masën mbrojtëse sipas vendimit (01/76 datë 21/11/2018) të Qeverisë. "Duke parë të nevojshme për të sqaru-

ar tutje, të gjitha donacionet me mallra që sillen në Kosovë sipas procedurave ligjore, si dhe të gjitha mallrat për personat fizikë dhe udhëtarëve sipas të drejtave ligjore nuk janë ndaluar nga Dogana dhe të gjitha janë liruar në përputhje të procedurave të Kodit Doganor dhe ligjeve të tjera në fuqi.

Gjithashtu, njoftojmë se trafiku i mallrave komerciale vazhdon normalisht sipas ligjeve dhe vendimeve që janë në fuqi. Çdo palë që ka paqartësi rreth procedurave ju lutem drejtohuni te Dogana e Kosovës, ku do t'i japim sqarimet dhe udhëzimet e nevojshme", është thënë komunikatën e Doganës.







me programin e AAK-së dhe që janë të dobishme për zhvillimin e vendit. Në periudhën e qeverisjes Haradinaj për më pak e më shumë se një vit kanë filluar të zbatohen masa nxitëse zhvillimore, si politikat fiskale, janë eliminuar pengesat në sektorin e prodhimit të energjisë, është finalizuar marrëveshja për Termocentralin "Kosova e Re" pas 12 vjetësh zgjatje, është venë në dispozicion të interesave të publikut një pjesë e madhe e pasurive të mbajtura nga Agjencia e Privatizimit etj. Me çfarë janë krijuar kushte të favorshme për rritjen e investimeve private dhe publike. Kjo na siguron se shumë shpejt ta arrijmë synimin tonë për rritjen e BPV-së mbi 7 për qind në vit.

**"Epoka e re":** Kosova në vazhdimësi është kritikuar për mungesë të atashëve ekonomikë. Çfarë keni në plan të bëni për këtë?  
**Shatri:** Ky segment i rëndësishëm nuk është shfrytëzuar deri më tani. Ministria e Jashtme ka marrë udhëzimet e nevojshme. Presim të kemi veprime të nevojshme për shfrytëzimin e këtij segmenti për afirmimin dhe dinamizimin e aktiviteteve ekonomike me jashtë.

**"Epoka e re":** Po ashtu, projektbuxheti është kritikuar për rritje të shpenzimeve për paga dhe mëditje, si dhe rritje në skemat sociale. Cili është mendimi juaj për këtë?  
**Shatri:** Për pagat mendoj se është dhënë përgjigjja në pyetjet e mëparshme. Kategoria e subven-

cioneve dhe transferimeve pritet të rritet vitin e ardhshëm për 16 për qind, respektivisht për pensionet e kontributdhënësve për 15 për qind dhe pensionet e moshës për 20 për qind. Pas këtij viti nuk parashihet ndonjë rritje esenciale e kësaj kategorie për dy vjetët pasues. Kur jemi te ky problem nuk guxojmë ta harrojmë faktin se Qeveria aktuale e ka gjetur vendin me shkallë të lartë të papunësisë dhe varfërisë, rreth 30 për qind. Fakt ky që domosdoshmërisht ta imponon nevojën e vëmendjes së posaçme të Qeverisë për këtë kategori të popullsisë. Kjo drejtpërdrejt reflektohet në strukturën e shpenzimeve buxhetore.

**Epoka e re":** Z. Shatri, Qeveria ka marrë vendim për taksë 100

përqindësh ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës. Sa mendoni se do të zgjasë kjo taksë?

**Shatri:** Taksa mbrojtëse e vendosur nga Qeveria e Kosovës ndaj mallrave serbe dhe të Bosnjë Hercegovinës ka ardhur si masë ndaj sjelljeve të këtyre dy vendeve karshi shtetit të Kosovës. Kjo masë nuk është e afatizuar. Masa do të jetë në fuqi deri në ndryshimin e sjelljes së këtyre dy vendeve ndaj Kosovës. Deri më tani Serbia e ka shfrytëzuar tregun e Kosovës pa asnjë pengesë, në të njëjtën kohë ka penguar plasmanin e mallrave të Kosovës në Serbi. Pra, Serbia ka vënë një varg masash dhe pengesash formale dhe administrative me të cilat ka penguar qarkullimin e

mallrave të Kosovës jo vetëm drejt Serbisë, por edhe drejt vendeve të tjera që kanë kaluar nëpër Serbi. Gjithashtu, Serbia ka shkelur vazhdimisht rregullat e CEFTA-s dhe marrëveshjet e Brukselit. Askush nga faktori ndërkombëtar që ka ndërmjetësuar bisedimet nuk ka reaguar. BE-ja nuk ka reaguar as për mosfunksionalizimin e pikave kufitare nga ana e Serbisë, për të cilat BE-ja ka investuar.

Serbia në marrëdhëniet ekonomike me Kosovën ka bërë pengesa në transport, në energji dhe në konkurrueshmëri. Po ashtu, nuk respektohen rregullat e origjinës së mallit dhe bashkëpunimit doganor, përdorin vula doganore paralele, nuk bashkëpunojnë për menaxhimin e integruar të kufijve, nuk i njohin certifikatat sanitare dhe fitosanitare të Kosovës, por i detyrojnë kompanitë kosovare të nxjerrin certifikata në Serbi dhe kjo kërkon kohë dhe shpenzime shtesë të cilat janë të papërballueshme për bizneset tona. Pengojnë në funksionalizimin e linjës së tensionit të lartë Kosovë - Shqipëri, nuk mundësojnë pagesën e energjisë të shpenzuar në veri, llobojnë kundër anëtarësimit të Kosovës në institucionet ndërkombëtare, subvencionojnë mallrat serbe që eksportohen në Kosovë etj. Pra, masa mbrojtëse e Kosovës do të hiqet në atë moment kur Serbia e njeh Kosovën shtet sovran dhe të pavarur, që nënkupton edhe ndërprerjen e veprimeve destruktive ndaj Kosovës.

**"Epoka e re":** Si do t'u përgjigjeni presioneve ndërkombëtare, se vendimi për taksën është në kundërshtim me CEFTA-n?

**Shatri:** Faktori ndërkombëtar duhet të jetë objektiv dhe i paanshëm. Vendimet e CEFTA-s dhe MSA-ja janë shkelur në mënyrë permanente nga Serbia. Ata (faktori ndërkombëtar) asnjëherë nuk kanë reaguar ndaj veprimeve destruktive të Serbisë ndaj Kosovës. Ne kemi plot argumente dhe do t'ia prezantojmë prapë faktorit ndërkombëtar. Po ashtu, e kuptojmë se kjo masë ka qenë e dhimbshme për Serbinë, sepse flitet për një humbje të tregut prej 500 milionë eurosh në vit, dhe kjo nuk është pa pasoja për ekonominë e dobësuar serbe, e cila e ka konsideruar tregun e Kosovës si treg të brendshëm të vetin. Është koha që autoritetet serbe ta kuptojnë se Kosova është shkëputur nga okupimi ushtarak e policor në qershor të vitit 1999, por me këtë vendim edhe nga okupimi ekonomik.

## Më 3 dhe 4 dhjetor mbahet Panairi i Agrobiznesit "Prishtina 2018"

PRISHTINË, 2 DHJETOR (ER) - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) me mbështetjen e Qeverisë së Kosovës organizon Panairin e produkteve bujqësore, agroindustriale dhe tregtisë inverse "Prishtina 2018", me qëllim të promovimit të kompanive kosovare dhe produkteve të tyre brenda Kosovës, rajonit dhe më gjerë.

Fokusi i këtij panairi është shporta e produkteve kosovare, prandaj nën temën #ShportaJonë do të ekspozohen dhe promovohen kompanitë e pranishme. Në këtë panair marrin pjesë 36 kompani nga Kosova dhe një nga Italia. Ky panair është i një dimensionit më ndryshe pasi organizohet

brenda kornizës së ngjarjeve të lidhura me javën e CEFTA-s, ku do të marrin pjesë aktorët më të rëndësishëm që shtynë drejt rritjes dhe zhvillimit të bizneseve të Ballkanit Perëndimor. Në këtë panair organizohet edhe ngjarja "Shija vendore" ku nga ora 18:30 deri në orën 20:30 më 3 dhjetor do të bëhet degustimi i



pijeve dhe ushqimeve vendore. Hyrja dhe transporti për vizitorët

e panairit është falas, çdo 30 minuta.

## Sot zbulohet busti i veprimtarit të çështjes kombëtare, Halil Mehmetaj

DEÇAN, 2 DHJETOR (ER) - Komuna e Deçanit ka bërë me dije se sot (e hënë) në fshatin Isniq do të zbulohet busti i veprimtarit të çështjes kombëtare dhe veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Halil Mehmetaj. "Të nderuara familje të dëshmorëve, invalidë dhe veteranë të luftës së UÇK-së, qytetarë të nderuar, ju njoftojmë se ditën e hënë, më 3. 12. 2018, në orën 12:00, në fshatin Isniq bëhet zbulimi i bustit të veprimtarit të çështjes kombëtare, veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Halil Mehmetaj, në njëvjetorin e ndarjes nga jeta. Zbulimi bëhet në fshatin Isniq,



te varrezat e fshatit aty ku pushon përjetësisht trupi i tij. Pjesëmarrja juaj nderon gjakun e dëshmorëve dhe luftën e drejt të UÇK-së!", është thënë në njoftimin e Komunës së Deçanit.



Në patronatin e Kryetarit të Komunës z. Smajl Latifi organizohet tubim dhe akademi përkujtimore



Muhamet Malsori Hysni Duraku Skender Hameli Sinan Hoti Isak Hoti Sedat Hoti Hida Hoti Ismet Hoti

## Të martën mbahet akademi përkujtimore për dëshmorët e rënë në malet e Pashtrikut

RAHOVEC, 2 DHJETOR (ER) - Merastin e 20-vjetorit jubilar të rënies heroike të dëshmorëve të kombit, Muhamet Malsori, Hysni Duraku, Skender Hameli, Sinan Hoti, Isak Hoti, Sedat Hoti, Hida Hoti dhe Ismet Hoti, të rënë në malet e Pashtrikut më 4 dhjetor 1998, të martën do të bëhen homazhe te vendi i

rënies në Pashtrik si dhe do të mbahet akademi përkujtimore në Krushë të Madhe. Aktivitetet organizohen sipas kësaj agjende: Në orën 10:30 bëhet nisja nga oborri i Shkollës Fillore "Bajram Curri", në orën 11:00 bëhen homazhe në kompleksin memorial në Krushë të Madhe, në orën 11:30 bëhet

nisja për në malet e Pashtrikut, te vendi i rënies, dhe në orën 17:00 në Shtëpinë e Kulturës "Muhamet Malsori" do të mbahet akademi përkujtimore kushtuar këtyre dëshmorëve. Tubimi dhe akademja përkujtimore organizohen nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi.



## Miratohet statuti i Teatrit 'Adriana Abdullahu'

FERIZAJ, 2 DHJETOR (ER) - Me ftesën e kryesueses së Kuvendit të Komunës së Ferizajt, Kristina Gashi-Bytyçi, është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës, në të cilën janë diskutuar një varg çështjesh. Në këtë mbledhje të Kuvendit

është diskutuar edhe për statutin e Teatrit "Adriana Abdullahu", me ç'rast me shumicë të votave është miratuar ky statut. Po në këtë mbledhje është diskutuar edhe propozim-vendimi për themelimin e Muzeut të Kujtesës, zotim ky i

kryetarit të Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, e cila do të shërbejë për promovimin më të mirë të vlerave historike, përkatësisht materialeve dhe dokumentacionit tjetër nga lufta e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

## Fillon zbatimi i projektit për emërtimin e rrugëve në Prizren

PRIZREN, 2 DHJETOR (ER) - Në qytetin e Prizrenit ka filluar implementimi i projektit për emërtimin e rrugëve. Sipas njoftimit të Komunës së Prizrenit, ky projekt është zvarritur për dy vjet me radhë, për ta lënë Prizrenin qytetin e fundit në Kosovë që ende nuk i ka të shënuara rrugët. "Pas kompletimit të procedurave të nevojshme, sipas planit

dinamik, projekti parashihet të përfundojë deri në fund të vitit të ardhshëm. Projekti filloi me rrugën 'Adem Jashari', pikërisht më 28 nëntor, në ditëlindjen e tij. Emërtimi i rrugëve të komunës, përveçse ndihmon në organizimin e qytetit, është një ndër kushtet për liberalizim të vizave të kërkuara nga BE-ja", është thënë në njoftimin e Komunës së Prizrenit.



## Rufki Suma vizitoi bashkatdhetarët në Celano

PRISHTINË, 2 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, ka vizituar bashkatdhetarët në Celano të Italisë. Sipas njoftimit të kësaj komune, Suma është pritur ngrohtësisht nga bashkatdhetarët dhe qytetarët e Celanos. "Ishin shumë raste nga vendësit që për një moment ndalën kryetarin Suma me të cilin dëshironin të shkëmbejnë disa fjalë. Komentet e tyre ishin fjalë respekti për vizitën e

kryetarit, para së gjithash, fjalë respekti për të gjithë bashkatdhetarët tanë që punojnë në Celano me rrethinë. Bashkatdhetarët ishin nga më të ndryshëm, avokatë, mjekë, afaristë, mjeshtrë, zyrtarë komunalë e në shumë raste të qytetarëve të Celanos që dëshironin që me pak fjalë t'i dëshmojnë kryetarit për respektin e tyre për vendësit tanë", ka njoftuar Komuna e Hanit të Elezit.



# Larot e retorikës

Sot në Kosovë ka dekanë fakultetesh, rektorë universitetesh, "autorë veprash", ministra, zëvendësministra, deputetë, analistë (të vetëquajtur), akademikë, intelektualë etj. që nuk dinë as të flasin, as të shkruajnë drejt në gjuhën amtare, në gjuhën standarde shqipe, mosnjohja e së cilës, për postet e sipërthëna, është deficit e komprometim i madh arsimor, retorik, linguistik, akademik, intelektual etj.



Hasan MUJAJ

Do vënë në dukje se në dhjetëvjetëshin e parë të shek. XXI, por pjesërisht edhe më pas, atëherë kur, si rrjedhojë e mosfunksionimit ligjor të institucioneve kompetente, në disa universitete private dhe në disa veprimtari të tjera, mullulluan shpërdorime të mëdha. Kështu, në këto institucione sikur ndryshoi destinimi i arsimit të lartë nga burim dijeje e edukimi, në biznes me përfitim të lartë financiar.

Në disa universitete private të Kosovës, të Shqipërisë e të Maqedonisë u bë e po bëhet degradimi i arsimit të lartë, depërtimi i pseudoshkencës, stagnimi i dijes së mirëfilltë, rënia e cilësisë së studimeve dhe e fjalës artistike nga krijuesit kiçë, nga rrënues të vlerave, nga ata që Faik Konica me të drejtë i quante "laro të penës".

Termi "laro", i përdorur edhe nga Fan Noli në vjershën elegjike për Luigj Gurakuqin në kuptimin e veprimtarisë kriminale, nënkupton "njeriun që i shërben tjetrit për të përfituar diçka prej tij, që e shet veten për një kockë, zuzar; kur njëri do të rrëmbejë çdo gjë për vete... etj". (Fjalori i gjuhës shqipe).

Mund të thuhet se sot ka edhe laro të retorikës. Njerëz që shkruajnë e flasin sipas diktatit për ndonjë përfitim. Ata, me gjithë mungesën e përgatitjes së duhur arsimore, sociokulturore, retorike etj., kanë pretendime të mëdha për poste të larta pushteti; ata jo vetëm që janë shtrembërues të retorikës pozitive e korrekte të shkruar e të folur, përjashtues të vlerave të qëndrueshme, por njëkohësisht shërbejnë si vegla të ekzekutimit të vendimeve të mentorëve të tyre, të cilëve u shërbejnë me devotshmëri, në rastin e vrojtimit tonë, edhe të

krimeve intelektuale, arsimore, shkencore, etike, akademike etj. Laro të retorikës janë edhe ata që, në fjalimet publike, bëjnë premtime hiperbolistike për zhvillime të reja me të cilat, siç thonë, do të ngrihet standardi i jetës së qytetarëve, do të shtohet punësimi etj. dhe në fund të gjitha dalin shterpë, ngjashëm me thënien metaforike: "do të ndërtojmë urë dhe aty ku nuk ka lumë!" Pra, në thelb qëllimi i fjalimit është përfitimi politik i liderit, i lidershit dhe i klubit politik të cilit i përkasin laro. Kështu, me zuzëri, laro kanë depërtuar në Qeveri, në Parlament, në universitete etj. Ka laro të vegjël, të cilët, për t'i ruajtur privilegjet e pushtetit, i mbrojnë laro e mëdhenj nga kritikë e themelja që u bëhen për bëmat kardinale korruptive për lemeri zuzarësh për statusin e veteranit të luftës. Për t'i ikur ndjekjes penale të mashtrimit, laro reagojnë me pompozitet me protesta e kërcënime madje me kanun ndaj prokurorëve që i ndjekin falsifikimet dhe vetëshpallen si apologë të vlerave të luftës!

Vlerat e luftës janë të shenjta, por ato vlera, përherë të ndritura, mbrohen e kultivohen duke e thënë të vërtetën dhe jo duke e mashtruar shtetin.

## Mungesa e edukimit etik

Laro edhe dje, edhe sot, me anë korupsioni e favoresh të ndryshme, pra shpërdorimisht, blejnë edhe grada të larta shkencore, marrin titullin doktor shkence me disertacion doktorate të kopjuar - plagjiaturë, shënohen si autorë veprash e punimesh që i shkruajnë të tjerët me pagesë në emër të tyre; laro avancohen pa meritë në gradat akademike, zgjidhen profesorë universitetesh me punime plagjiaturë me vlerësimin e "recensentëve" nergut të porositur pa përmbushur asnjë kriter as ligjor, as akademik madje vihen edhe në poste të larta drejtuese të shtetit! Andaj, nuk është befasi që sot në Kosovë ka dekanë fakultetesh, rektorë universitetesh,

"autorë veprash", ministra, zëvendësministra, deputetë, analistë (të vetëquajtur), akademikë etj. që nuk dinë as të flasin, as të shkruajnë drejt në gjuhën amtare, në gjuhën standarde shqipe! Ky është degradimi i madh retorik, linguistik, akademik etj.

Këso deformimesh ndodhin nga mungesa e edukimit etik, didaktik, kulturor, shkencor etj. Sepse, ai që ka formim të mirëfilltë etik e shkencor, nuk do të lejojë veten të bjerë në shkallë qesëndie, kusarie e falsifikimi që të avancohet e të ngrihet me veprimtarinë e të tjerëve. Edukimi etik duhet të zhvillohet në secilin nivel të arsimit dhe në çdo fushë të veprimtarisë; ai duhet të jetë ligjërimit e mësimi i përhershëm madje edhe pas shkollimit të rregullt. Ai duhet të thellohet e të ngrihet posaçërisht (ndër të tjera) edhe në dy nga fushat parësore që paraqesin themelin e formimit kulturor, etik, estetik etj.: 1. në terrenin e zotërimit të gjuhës standarde dhe 2. në fushën e artit të letërsisë.

Nga kjo pikëpamje është shumë domethënësi citati i filozofit të shquar italian Benedetto Croce: "Quaj njeri atë që është zot i gjuhës amtare". Sipas porosisë së këtij citati, del e nënkuptueshme dilema se a mund të quhet njeri i formuar nga arsimit, edukimi, kultura etj. ai që nuk e zotëron gjuhën amtare? Jo. Assesi.

Nelson Mandela vlerësoi lart rolin e edukimit për formimin e personalitetit; ai shkroi: "Edukimi është arma më e fortë që ju mund ta keni për ta ndryshuar botën".

Nga përmbajtja e këtij citati mund të kuptohet se ish-kryetari i Afrikës së Jugut N. Mandela, luftëtar i shquar kundër racizmit, me të drejtë edukimin e kishte parë si mjetin më të fuqishëm për zhvillime të reja progresive përmasash globale.

Është brengosës fakti që askush nuk merret me dënimin dhe mënjanimin e dukurisë së shpërdorimeve shkencore për ngritjen akademike fals. Nga retorika antike ishte kriteri i pakapërcyeshëm që oratori të ketë tipare të larta etike sepse në këtë mënyrë do të paraprihej nga kultura morale për të zgjedhur stilin e komunikimit pragmatik, etik dhe sociokulturor.

Po qe se mungon kriteri etik siç po ndodh shpesh, nëse nuk ka përgjegjësi masash ligjore për veprimtari të dënueshme edhe në fushën akademike siç po ngjet shpesh, atëherë nuk është habi se edhe në këtë nivel studimesh po merren tituj shkencorë të "doktoratave" plagjiaturë, po merren tituj shkencorë të blerë. Së këndej-

mi, del e kuptueshme se "doktorët e këtitillë të shkencave" nuk kanë stil të ngritur të komunikimit as gojor, as shkrimor; stili i fjalimit e i shkrimit të tyre është në shkallën më të ulët të ndërtimit të tekstit jo vetëm nga etika, porse edhe nga estetika, stilistika, sociologjia e kulturës, gjuha standarde dhe shkencat e tjera. Komunikimi i gjerë i stilit steril është vërtetim i doktoratës kiç!

Oratorët - autorët, në paraqitjet e tyre publike, duhet të gjurmojnë për ta gjetur fjalën, semantika e së cilës i përgjigjet së vërtetës. Në shumë raste nuk veprohet kështu, prandaj krijohet shpërpjesëtimi kuptimor midis së thënës (artificiale) dhe reales. Ja një ilustrim që u shkrua dhe u tha në medie: një orator-autor metaforat "rrugaç", "hajn" etj., që ia drejtoi një prokurori të prokurorisë speciale jo vetëm që nuk e shprehin realitetin sepse prokurori ka një status të lartë social dhe një formim të verifikuar profesional, veçse (metaforat e nivelit të analfabetëve) dëshmojnë deficitin e madh arsimor, kulturor, etik etj. të oratorit. Kështu shprehen vetëm ata që nuk kanë forcë shprehjeje as pasuri leksikore. Forca e shprehjes ekziston në poliseminë gjuhësore, në krijimtarinë letrare, në frazeologjinë popullore; ajo duhet të kërkohet në gjerësinë e gjuhës, në visarin leksikor të saj, në teorinë e letërsisë dhe të ndërtohet me mjetet e tyre; ajo duhet të vihet në funksion të elokucionit, të persuasionit dhe të standardeve të tjera të retorikës. Por, ç'të bëjë ai që s'ka forcë formimi të shprehjes, të stilizimit? Sigurisht se ai nuk di ta ndërtojë stilin e komunikimit kulturor, prandaj (ai) ka dy mundësi: 1. të mos ekspozohet publikisht në medie për të demonstruar varfërinë e shprehjes, dmth. të heshtë dhe 2. detyrohet t'u referohet fjalëve të stërkonsumuara që secili i gjen në rrugë që nga fëmijëria. Më mirë do të ishte ta ndiqte mundësinë e parë sesa të bëhet objekt talljeje e humori.

## Mungesa e retorikës realiste

Fjalimi publik duhet të zhvillohet në përputhje me faktorët më të rëndësishëm të jetës dhe të veprimtarisë si p. sh. aktualiteti, zhvillimi ekonomik, arsimit dhe kultura, shëndetësia, kërkesat e qytetarëve etj. Që nga Aristoteli është vënë në dukje faktori i edukimit të të rinjve përmes arsimit të fortë. Sot sikur nuk i kushtohet vëmendje e duhur këtij faktori. Arsimit i dobët shpie në mosfunksionimin juridik të shtetit në çdo fushë të veprimtarisë, andaj edhe në fushën e kërkimit tonë, d.m.th. në fushën e retorikës dhe të komunikimit. Kjo dobësi e

madhe, si rrjedhojë e arsimit pa cilësi e pa kriter, vihet re përditë edhe në komunikimin e fjalimit publik. Kështu, vetëm fjalimi i sintetizuar mbi bazën pragmatike, i strukturuar mbi themelin e retorikës konstruktive, i shprehur me mjetet ekspressive të stilistikës dhe korrekt nga gjuha standarde, do të zgjojë kërshërinë e auditorit dhe besimin e kuptimit për t'i yshtur dëgjuesit se përmbajtja e fjalimit nuk është artificiale, nuk është premtim mashtrimi, porse vërtetësi e zbatueshme për ngritje të reja. Për këtë arsye në fjalimet publike duhet të kultivohet retorika realiste, e bashkëpunimit dhe e perspektivës dhe jo retorikë nacionaliste e romantike, e mashtrimit dhe e paradisë. Por, në praktikën e oratorisë jo vetëm në Kosovë, porse edhe në rajon, vështirë, shumë vështirë e rrallë rastis të dëgjohej ose të lexohen fjalime publike, sidomos politike, të cilat mund të shquhen nga përbërësit e sipërthënë, dmth. të identifikohen nga vlera ndërtimore dhe përmbajtjesore. Kjo ngjet nga fakti se dy përbërësit kryesorë: ndërtimi dhe kuptimi i tekstit të fjalimit nuk kanë themel pararendës përgatitor as teorik, as praktik dhe, ç'është për çdo kritikë, asnjë nga institucionet kompetente nuk e ngre çështjen e ndërtimit të themelit të diturive të retorikës tok me shkencat e tjera të përafërta. Dhe, nuk mund të priten përmirësime në këtë pikëpamje përderisa në organet drejtuese të institucioneve përkatëse gjenden e vihen njerëz me deficit të madh të kulturës së komunikimit, fjalimet e gjora të të cilëve po dëgjohej e po lexohen përditë në medie të ndryshme. Stili i fjalimeve publike të oratorëve të lartë të shtetit në Kosovë është aq i varfër, aq i thatë, aq dialektor, saqë mund të dëgjohej ditëve të tregut në shitblerje e sipër.

Ai është dëshmi e mungesës së shkollimit. Zyrtarët e këtitillë nuk janë për foltore. Pasi është kështu, si të papërgatitur që janë nga kjo pikëpamje, ata nuk kanë hyrë në politikë për të sjellë kthesa pozitive zhvillimi, porse kanë hyrë për përfitime të nduarnduarta.

Ish-kryetari i Shqipërisë Alfred Moisiu, në një shkrim, me të drejtë vuri re se është krijuar bindja se për të siguruar një vend pune dhe për t'u pasuruar, duhet të futesh në politikë! Nga kjo mund të nënkuptohet se në veprimtarinë politike nuk duhet ndonjë përgatitje, se aty mund të futet secili që ka mbështetje miqësore e lidhje të ndryshme favorizuese pa marrë parasysh dhuntinë, shkollimin, prirjen, formimin retorik etj.

## Protestat e dhunshme, Franca mund të kalojë në gjendje të jashtëzakonshme

PARIS, 2 DHJETOR - Presidenti francez Emmanuel Macron ka konsideruar të shpallë gjendje të jashtëzakonshme për ta parandaluar përsëritjen e protestave të dhunshme si dhe ka bërë thirrje për bashkëbisedim me protestuesit, tha zëdhënësi Benjamin Griveaux. Grupe të rinjve me maska në

fytyrë, si dhe mjete të forta, kanë protestuar në rrugët e Parisit duke shkakuar dëme të mëdha materiale në vetura dhe ndërtesa. "Duhet të mendojmë për veprimet që duhet të ndërmerim për të mos përsëritur këto incidente", tha Griveaux. Autoritetet u zunë në befasi nga eskalimi në dhunë pas dy javë

protesta në gjithë Francën kundër ngritjes së taksës së naftës.

Presidenti Emmanuel Macron do të mbajë një takim me kryeministrin dhe ministrin e Brendshëm francez për të diskutuar rreth protestave dhe dialogut të mundshëm me protestuesit, të njohur si

"xhaketat e verdha", që nuk kanë lider apo udhëheqës, por u mobilizuan përmes rrjeteve sociale.

Protestat filluan më 17 nëntor dhe shumë shpejt u rritën në numër, duke bllokuar rrugët në gjithë Francën si dhe qarkullimin nëpër shumë vende publike.



## Përgatitje për funeralin e ish-presidentit George Bush

George H. W. Bush, i cili shërbeu një mandat në Shtëpinë e Bardhë (1989-1993) do të nderohet me një funeral shtetëror të mërkurën në Katedralen Kombëtare në Uashington, nga ku do të nisët për varrim të enjten në truallin e bibliotekës së tij presidenciale në Teksas

WASHINGTON, 2 DHJETOR - Trupi i ish-presidentit të ShBA-së, Xhorxh H. W. Bush, do të vendoset për homazhe në ndërtesën e Kongresit, duke filluar të hënën mbrëma, ku amerikanët do ta nderojnë jetën e presidentit të 41-t të vendit. Ndërtesa do të jetë e hapur për personalitete dhe publikun që do të tregojë respektin deri të mërkurën dhe vizitorët do të kalojnë para arkivolit të ish-presidentit Bush. Ai vdiq në Teksas, në shtëpinë e vet, të premtën mbrëma në moshën 94-vjeçare.

George H. W. Bush, i cili shërbeu një mandat në Shtëpinë e Bardhë 1989-1993, do të nderohet me një funeral shtetëror të mërkurën në Katedralen

Kombëtare në Uashington, nga ku do të nisët për varrim të enjten në truallin e bibliotekës së tij presidenciale në Teksas. Shtëpia e Bardhë njoftoi të shtunën se presidenti Donald Trump do të marrë pjesë në funeral.

Në një koment në "Twitter", udhëheqësi amerikan tha: "Presidenti George H. W. Bush pati një jetë të gjatë, të suksesshme dhe të bukur. Sa herë që isha në praninë e tij, pashë gëzimin e tij absolut për jetën dhe krenarinë e vërtetë për familjen e tij. Ai ishte një njeri vërtet i mrekullueshëm dhe të gjithë do ta ndiejnë mungesën e tij!"

Sekretarja e shtypit të Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders, tha në



një deklaratë se e mërkura është caktuar ditë zie kombëtare dhe se flamujt e Shtëpisë së Bardhë tashmë janë ulur në gjysmësh-tize për ta nderuar ish-presidentin George H. W. Bush.

Bursa e Nju Jorkut njoftoi se do

të mbyllet të mërkurën për nder të ish-presidentit Bush.

Funeralet shtetërore mbahen tradicionalisht për presidentët e tanishëm ose të mëparshëm dhe zyrtarë të tjerë të caktuar nga presidenti. Funerali shtetëror

është një ngjarje dhjetëditore dhe përbëhet nga tri faza: ceremonitë brenda shtetit ku zyrtari ka banuar, ceremonitë brenda Uashingtonit, dhe ceremonitë në shtetin në të cilin individi ka zgjedhur për t'u varrosur.

## Udhëheqësit botërorë në samitin G-20 bien dakord për disa gjëra

BUENOS-AIRES, 2 DHJETOR - Në takimin e udhëheqësve botërorë të mbledhur në Argjentinë, presidenti Donald Trump u shfaq me tematikën e politikës së tij të jashtme "Amerika e para". Rezultati ishte një samit me pak marrëveshje të arritura. Në samitin shumëpalësh mbizotëroi ndërveprimi dypalësh.

Me gjithë valën në rritje të nacionalizmit në mbarë botën, në samitin e G20-ës në Argjentinë u bë një përpjekje për bashkëpunimin ndërkombëtar.



Çështjet e debatueshme, si emigracioni dhe tregtia, përgjithë-

sisht u shmangën. Për ndryshimet klimatike, ShBA-ja

thjesht doli kundër të gjithëve. Në një intervistë me shërbimin në gjuhën spanjolle të "Zërit të Amerikës", sekretari i Shtetit, Mike Pompeo, tha se Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të jenë të përkushtuara ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar. "Krijimi i prosperitetit për çdo qytetar të botës. Krijimi i rregullave që e mundësojnë këtë gjë. Këto janë temat e përbashkëta. Ndonjëherë debatojmë për mënyrat se si t'i realizojmë këto. Por, të gjithë synojmë të njëjtat

objektiva", tha Sekretari Pompeo. Por, ndërsa vendi më i fuqishëm i botës bën haptazi thirrje që interesat kombëtare të kenë përparësi, disa vende më të vogla shqetësohen për dobësimin e institucioneve ndërkombëtare. "Nuk është gjë e mirë për ne, pasi jemi vend i vogël dhe na duhen rregullat që t'ia dalim më mirë. Nëse mbetemi me vetëm politikën e forcës, atëherë do të dalim humbës", thotë Roberto Bouzas, profesor i ekonomisë në Universitetin e San Andreas.

## Kryeministri izraelit akuzohet për korrupsion dhe rryshfet

TEL-AVIVI, 2 DHJETOR - Autoritetet në Izrael deklaruan se kanë mbledhur prova të mjaftueshme për akuzat e korrupsionit të cilat do të paraqiten ndaj kryeministrit Benjamin Netanyahu dhe gruas së tij.

Autoritetet akuzojnë Netanyahu për kryerjen e favoreve ndaj një kompanie të telekomunikimit në këmbim të publikimit të lajmeve pozitive për të dhe gruan e tij nga portal Walla që mbikëqyret nga kompania. Netanyahu ka mohuar

këto akuzat. Kjo do ta shkaktojte sfidën më të madhe të mbijetesës politike të kryeministrit që mbajti katër mandate. Vendimi final do të merret nga prokurori gjeneral, i cili është i ngarkuar edhe me dy akuzat tjera ndaj Netanyahut. Akuzat

ndërlidhen me pranimin e dhuratave nga biznesmenë si dhe favore të ndryshme politike. Përfaqësuesit e tjerë politikë kanë thënë se do ta presin vendimin final të prokurorit për t'u deklaruar lidhur me këtë situatë.



# Shqipëria në sytë e mprehtë të Faik Konicës

Bujar Mehulli

"Shqipëria si m'u duk" është një ndër veprat më të rëndësishme të Faik Konicës, në të cilën ai do të bëjë një analizë të hollësishme psikologjike, të shqiptarëve të asaj kohe, duke pasur për bazë udhëtimin e tij në Shqipëri që e ndërmoi në vitin 1928. Pra, "Shqipëria si m'u duk" u shkrua në po këtë vit. Ky tekst i Konicës është krejtësisht dokumentar dhe i argumentuar, pa munguar ngjyrimet e njohura të satirës.

Në themel të këtij teksti të Konicës është ideja që ai e trajton dendur nëpër të gjitha tekstat e tij, e që është pengimi i çështjes kombëtare nga vetë shqiptarët, të cilët ai i ndan në disa shtresa si: Ekspertët, Robotët (apo njerëzit makina), dhe Levantinët. Këta të fundit, sipas Konicës, janë më të rrezikshmit; ata kanë humbur çdo veti karakteristike kombëtare dhe nuk ngurrojnë ta nënvlësojnë e mohojnë çdo vlerë të mirëfilltë atdhetare, derisa mitizojnë gjithçka të huaj. Pra, janë snobë. Në ballafaqimin e madh të psikologjisë etnike të popullit tonë, me psikologjinë tjetërsuese të levantinëve, kristalizohet në këtë vepër qartë e thjeshtë rëndësia e ruajtjes së autenticitetit të çdo gjëje kombëtare në të gjitha fushat si në: psikologji, kulturë, art, zakone etj.

Faik Konicë është një ndër përfaqësuesit më të shquar të lëvizjes politike e kulturore shqiptare. Ai qe publicist, kritik letrar si dhe veprimtar politik, i cili përgjatë karrierës së tij la gjurmë të pashlyshme e të gjithanshme në lëvizjen kombëtare, politike, ideore e kulturore shqiptare.

Siç e thamë, titullin "Shqipëria si m'u duk", Konicë ia vendos tekstit pasi që kthehet për herë të fundit në atdhe dhe bën një përshkrim të gjatë të asaj çfarë pa dhe përjetoi në tokën shqiptare se cilës ai, ia kushtoi gjithë jetën. Në këtë tekst, kemi të bëjmë edhe me Mbretin Zog, i cili kish konsoliduar pushtetin dhe kish krijuar njëfarë stabiliteti në vend, duke shpallur kështu mbretërinë.

Me t'u kthyer Konicë në Shqipëri, Zogu i bën një pritje aristokrate, e cila i pëlqen Konicës. Zogu e dërgon sekretarin në Durrës që ta marrë Konicën dhe t'i shpreh mirëseardhjen në Tiranë. Pas akomodimit, të cilin Konicë e përshkruan në tekst, vijnë pritjet, takimet e nivelit të lartë, pastaj drekat dhe darkat, bisedat në zyrë e kështu...

Këtu kemi luhajtjen e Faik Konicës. Dhe mbas gjithë kësaj sikur na del përpara një Konicë i ri, ndryshe nga ai që qemë mësuar ta shohim. Tani na shfaqet një Faik Konicë, i cili largohet nga të menduarit kritik, nga akuzat që ia atribuonte atij, duke ia lëshuar vendin lëvdatave

ndaj Mbretit Zog, të cilin madje e krahason edhe me Skënderbeun. Mbase këtu kemi të bëjmë me dinakërinë e Zogut, që si njeri i pushtetshëm dhe tejet i shkathhtë, ia del të ngadhënjejë mbi mendjen e mprehtë të intelektualit të madh.

Dhe për gjithë këto, në tekstin "Shqipëria si m'u duk", Konicë, sikur ia shpërblen Mbretit Zog dhe e neutralizon armiqësinë e gjatë që kishte me të.

Faik bej Konicë, në letrat shqipe paraqitet si njëri nga themeluesit dhe mjeshtrit e publicistikës letrare duke shkruar me qindra artikuj, pamflete, polemika, ese, e të tjera tekste të cilat zakonisht i botoi në revistën e tij Albania. Si publicist, kritik letrar dhe veprimtar politik përgjatë karrierës së tij ishte i pakrahueshëm, ai la kudo gjurmë të thella në lëvizjen kombëtare, ideore, politike e kulturore shqiptare.

Pa dyshim që ai ishte polemisti më i madh i kohës së vet, po kështu kritiku i parë në letërsinë shqipe me Kohëtorin e tij të famshme. Objektivit kryesor i Konicës, qëndron te frymëzimi perëndimor dhe ambicet e tij madhore, të cilat mendon t'i përcjellë në Shqipëri, dhe kështu ta krijojë vatrën e lëvizjes shqiptare në mes të Evropës.

Në krijimtarinë e tij të pasur, padyshim një vend relevant e zë publicistika; tema qendrore që Konicë e trajtoi në publicistikën e tij, ishte ajo atdhetare dhe problemet rrotull saj, lëvizja kombëtare dhe në përgjithësi fati i Shqipërisë.

Me po këto gjëra merret edhe te udhëpërshkrimi "Shqipëria si m'u duk", ku shfaq shqetësimet e tij për gjendjen dhe fatin e atdheut të robëruar, që vërehen edhe në tekstat tjera të tij.

Para se të flasim më shkoqur për "Shqipëria si m'u duk" do të flasim pak për karakterin e Konicës, i cili shpërfaqet kudo edhe në tekstat e tij.

Konicë qe aristokrat i lindur, dhe si i tillë u prit kudo me nderim. Por jo pak herë i ndodhi që mos të kuptohej nga shqiptarët, të cilët më vonë s'do të ngurrojnë fare, t'i shajë e t'i tall ashpër.

Ai nuk mund ta shihte askënd sipër vetes, e as pranë vetes. Ishte njeri shumë i pasionuar mbas artit të mirëfilltë, dhe shijes së hollë. Gjatë gjithë jetës së tij, Konicë, u përsiat për cilësi dhe stil. Në Shqipëri, shpeshherë pati punë me njerëz që ishin të prirur kah anadollizmi, të cilin ai u përpoq meoemos ta flakë jashtë Shqipërisë. Njeri i jashtëzakonshëm me shpirt të çuditshëm; i dashuruar thellësisht me Shqipërinë, saqë asaj qe i gatshëm t'ia kushtojë gjithë jetën e tij.

Shijen e tij të hollë, e shfaqti kudo në letrat e tij, shkroi e foli me delikatesë të madhe, me ndjenjat më të thella por gjithashtu shau,

kritikoi e satirizoi ashpër.

Për arsye të huave të mëdha që kishte, nuk na la vepra të plota; ai çdoherë shkroi me ëndjen për të shkruar. Vetëm kaq!

Ky ishte Faik bej Konicë! Njeri ekstremesh. Njeri i pasioneve të mëdha.

Tani, të kthehemi te teksti publicistik "Shqipëria si m'u duk", që është një ndër tekstat më interesante në letërsinë shqipe.

Konicë, tekstin e hap me nëntitullin Dukja e përgjithshme e vendit dhe me ëndërrimet e tij të pëlqyeshme nga të cilat ka frikë të zgjohej, sepse e shpien në një realitet jo të këndshëm, e largojnë nga bota e lulëzuar dhe e bukur, dhe e sjellin përballë gjërave të shëmtuara të tokës shqiptare.

Sikur në çdo tekst tjetër të Konicës, edhe këtu kemi të bëjmë me një përshkrim gjenial të ambienteve, njerëzve, gjërave etj...

Në vazhdim të tekstit, atë e përfshin nostalgjia për kohërat e bukura, për objektet, të cilat më s'i gjen në tokën e tij e cila kish degraduar ndjeshëm, më nuk i shihte syri kullat e Kohës së Mesme në Durrës, as kopshtet e bukura; Tiranë e rinisë së tij kish pamje krejt tjetër, e cila e mallëngjen së tepërmi por nuk e befason. Dhe më tutje, magjepset nga natyra e bukur shqiptare nga Dajti i lartë dhe madhështor, nga malet e Kruijës, dhe shumë brigje e male tjera të cilat gërhetojnë më vete të gjitha ngjyrat.

Kështu dalim te pjesa e dytë e tekstit që titullohet Mbreti, ku Konicë sikur bën thyerjen e madhe, sepse flet me nota sublime për Mbretin Zog, duke filluar nga takimet e tyre të hershme në Romë, pastaj vajtjet e tyre nëpër koncertet klasike në Vjenë, ku kishin dëgjuar simfoninë e njohura të Beethovenit e Moxartit. Pastaj vjen përshkrimi i shëndetit të Mbretit, për të cilin Konicë thotë se do ta kishte zili çdo njeri.

Ai madje akuzon kundërshtarët e tij që flasin e shkruajnë se gjoja Mbreti qe i sëmurë, duke ua bërë me dije të kundërtën; se Mbreti është më i shëndoshë se kurrë, dhe i gatshëm për detyrat madhore ndaj Shqipërisë.

Kah fundi i pjesës së dytë, Konicë shkruan për Mbretin Zog se: sikur të vejë gjithçka mbarë, Mbreti do të shpërthente në histori një hije më të madhe se hija e Skënderbeut dhe më pas, mbas kësaj fillon të shfaqet Konicë që jemi mësuar ta shohim zakonisht; duke kritikuar dhe thumbuar. Këtë nis ta bëjnë pjesën e tretë kur shkruan për ata, që ai i quan Ekspertët.

Këtu fillon shpata e sarkazmës koniciane, dhe tallja e tij e pamëshirshme me disa tipa që ai i quan ekspertë, e të cilët në masë të madhe e kishin vërshuar gjithë vendin.

Prapë ka lëvdata për Monarkinë e Zogut, e cila kish bërë disa ndryshime rrënjësore sipas tij në vend, por këta ekspertë ishin më

të patundur se Dajti, më të fortë se Tomori!, të cilët i emëron si racë prej tutkalli.

Sarkazma e tij nis me shkrimet nëpër gazeta të këtyre Ekspertëve që e bëjnë Shqipërinë kudo objekt talljeje, për shkak të huqeve, injorancës dhe snobizmit të tyre.

Sipas Konicës, këto tru të pazhvilluara i shfaqin haptas marrëzitë e tyre dhe madje edhe i botojnë nëpër gazeta të ndryshme duke i shkaktuar vendit dëm të madh edhe në arenën ndërkombëtare.

Ekspertët janë ata që s'kanë kapacitet intelektual, por që çuditërisht kanë hapësirë për t'i shprehur marrëzitë e tyre, madje të njëjtut tentojnë t'i bëjnë dëm edhe Mbretit gjenial, siç e quan Konicë, duke dashur t'i krijojnë atij imazh të keq para botës së qytetëruar.

Por, këta ekspertë nuk janë armiqtë e vetëm të Shqipërisë; Konicë paraqet një sojë tjetër të cilët i quan Robotët apo njerëzimakina.

Robotët, janë ata që shkaktojnë kaos të madh në jetën institucionale në Shqipëri, pasi që të njëjtut nuk e kanë fare ndjenjën e përgjegjësive dhe punojnë ashtu siç iu teket. Këta tipa, vendosin rregulla absurde sipas Konicës; rregulla krejt të panevojshme, të cilat s'vlejnë për asgjë veçe për ta vështirësuar jetën.

Ata janë të pazotë për të gjykuar vetë dhe për të marrë masat e nevojshme, por rrinë në një vend palëvizur, ose edhe kur bëjnë lëvizje, ato i bëjnë pa asnjë kuptim fare, ata ende punojnë me sisteme të vjetruara, të cilave bota e civilizuar medoemos kërkon t'iu ikë...

Në mbyllje e sipër të kësaj pjesë, Konicë na tregon se arritëm te shtresa më e rrezikshme e kombit shqiptar tek ata që ai i quan Levantinët apo Njerëzit e çkombëzuar.

Levantinët sipas Konicës, s'janë gjë tjetër veçe ca tipa që çdo gjë e vjetër shqiptare, u duket dhe poshtër dhe qesharake. Kështu ata shëmbëllojnë me njerëz gjysmë të egër, ata janë të prirur të vlerësojnë çdo gjë të paçmuar, qoftë edhe zërin e gozhdës të hasur në sharrë krahas zërit të ëmbël të violinës lozur nga ndonjë violinist i madh. Pra, këta Levantinët kanë besim se gjithçka që është e huaj është më e mirë dhe më e lartë se ata. Gjërërat që kudo nënvlërohen, te Levantinët lëre që s'flaken tutje por madje edhe përkraden.

Më vonë gjatë tekstit, Konicë bën një krahasim interesant me personazhin e Calibanit nga drama e Shekspirit Furtuna. Personazhi i Calibanit, është në gjendje t'i bie në gjunjë, t'ia puth këpuçët, ta konsideroj Perëndi, e të bëhet skllav i njërit që i ofron atij të pijë. Por, thotë Konicë, ky personazh është pjellë e Shekspirit dhe qëndron vetëm në letrat e pavdekura të tij, për t'i zbatimur njerëzit derisa

Levantinët të njëjtë me Calibanin, janë të gjallë dhe për fat të zi i bëjnë dëm kombit shqiptar.

Levantinizmin ai e sheh si një sëmundje tejet të rrezikshme për shqiptarët, së cilës do t'ia gjej burimin. Dhe e gjen; ata, para së gjithash janë imitues të dobët të gjithçkaje të huaj, edhe kur është e pavlefshme; shembullin që ata e ndjekin është i çuditshëm!

Ata përpiqen ta arrijnë idealin e berberëve të Bejollit të Stambollit, të cilët i marrin si heronjtë e qytetarisë ideale derisa të tjerët adhurojnë heronjtë e mendjes si Sokratin apo Abraham Linkolin. Kah fundi i udhëpërshkrimit, Konicë, tregon për një udhëtim drejt Bostonit që kish bërë me At Gjergj Fishtë, ky i fundit ish i mendimit se në Shqipëri nuk ishin vetëm disa levantinë, por levantina kishte nëpër qytete, kishte kudo anembanë Shqipërisë. Dhe se rreziku i madh ishte pikërisht këtu. Levantinët s'qenë një grup qesharakë, por një turmë që sa vete e shtohet, dhe kishte objektiv pakësimin e një shoqërie rrënjësore...

Këta levantinë, kishin gjithashtu një urrejtje për veshjen kombëtare të cilën Konicë e donte aq shumë saqë doli me të nëpër rrugët e Bostonit të Amerikës, për ta takuar Nolin. Por, levantinët janë të bindur se çdo kapelë e vendosur mbi kokë është orientale, përveç kapellos.

Këtu, Konicë tallet me injorancën e tyre për muzetë, librat duke i quajtur njerëz me tru të pagdhendur, të cilët kurrë s'e kishin parë muzeun Albertina në Vjenë, ku ishte vepra e artistit të madh gjerman Albreht Dyrer, në të cilën shfaqej babai i tij që mbante takije, e cila shëmbëllointe me takijen e Shqipërisë së Jugut në çdo pikë. Por berberët e Bejollit s'ia kishin fare haberin, dhe aq iu bënte për këtë. Ata, janë një turmë njerëzish të pastërvitur dhe të pa mend.

Faik Bej Konicë, kishte stil të jashtëzakonshëm për të bërë ironi. Ai po ashtu pati të gjitha vetitë për të qenë estetë i shquar: kulturën filologjike-estetike, shijen e artit dhe mprehtësinë e gjykimit. Këto prova që i kemi nga ai dëshmojnë qartas këtë. Ironia, që ishte arma kryesore e tij, u përdor me mjeshtëri nga ai, dhe me takt.


Dhe te "Shqipëria si m'u duk" ai ia arrin këtij ideali, me përshkrimet mbi anadollakët, e lolot e qytetërimit evropian - Robotë e Levantinë, që përbëjnë një humor të shëndoshë; krejt kjo nga frymëzimi i Faikut për idealin kombëtar.

Por, padyshim në këtë tekst veç kësaj, vend të rëndësishëm zënë edhe inatet politike e pasionet e pezmatuara, kështu ironia zmadhohet dhe bëhet sarkazëm, siç ndodh rëndom nëpër tekstat e Konicës, qofshin ato letrare apo publicistike.

**E rrallë**

## Ndërtesat e veçanta të Koresë së Veriut

Në arenën botërore, Koreja e Veriut njihet vetëm për udhëheqësin e saj, i cili shfaqet herë qesharak, herë i frikshëm për shkak të kërcënimeve. Si gjithë diktaturat e tjera, që nga Gjermania naziste e deri te Bashkimi Sovjetik, edhe Koreja e Veriut përpigjet ta propagandojë fuqinë nëpërmjet ndërtesave me përmasa të tepruara, të cilat nuk do të bëheshin në vende të tjera. Por, kjo ka bërë



që mes tyre të ketë ndërtesa me arkitekturë shumë të veçantë, shpesh tepër mbresëlënëse, edhe pse furnizimin me energji elektrike e kanë me orar.

**FOTO E DITES**



Një artist paraqet profilin e vet gjatë kohës sa ishte duke punuar në një skulpturë akulli në qytetin e Siberisë lindore të Yakutskut, në temperatura të ulëta. /AFP/

**E jashtëzakonshme**

## Demi gjigant që nuk e therin dot për mish

Zona rurale e Australisë perëndimore ka me miliona lopë, kështu që sigurisht ka parë nga të gjitha llojet e trajtat e tyre. Por kurrë nuk kishin parë si demi gjigant i quajtur Nikers. Nikers bie menjëherë në sy nga kopeja, sepse është 1.94 centimetra i gjatë, gati sa Michael Jordan dhe peshon 1.4 ton. Pronari u përpoq ta nxirrte në ankand, por thertoret e zonës thanë se nuk mund ta përpunonin në makineri, kështu që ai vazhdon të jetojë.



**DASHI**

Sot duhet t'i jeni mirënjohës një miku të


mirë që qëndron gjithmonë pranë jush kur keni nevojë. Shumë herë jeni më tepër egoist sesa që duhet.



**DEMI**

Ndjenjat janë ato që kanë dominim sot

dhe ju do të bëni çmos të kënaqni një person të veçantë që ju ka rrëmbyer zemrën.



**BINJAKËT**

Jeni duke keqkuptuar një situatë të caktuar sot

dhe si pasojë do të merrni vendime të gabuara që do të kenë në bazë këtë keqkuptim.



**GAFORRJA**

Disa zgjedhje profesionale që keni bërë

kohët e fundit nuk do t'i pëlqejnë aq shumë partnerit. Do të duhet të rri për një kohë larg njëri-tjetrit.



**LUANI**

Çdo gjë sot është në favorin tuaj dhe ju

ndiheni të përkëdhelurit e fatit. Mundohuni të afroni rreth vetes vetëm persona pozitive.



**VIRGJËRESHA**

Ka një ngërc në komunikimin në çift ose në familjen tuaj. Problemi është që të gjithë e dinë, por asnjë nuk po e pranon duke bërë të thellohet.



**PESHORJA**

Sot nuk do ta keni ndihmën e miqve për të zgjidhur një situatë shumë të tensionuar. Duhet të filloni të merrni vendime vetë dhe t'i argumentoni ato.



**AKREPI**

Sot do të harxhoni energji dhe para në një çështje që të gjithë e kanë abandonuar. Keni besim dhe do t'ia dilni të ktheni çdo gjë në favorin tuaj.



**SHIGJETARI**

Ndiheni të mbushur me kujtime të bukura lidhur me një person të caktuar. Kjo gjë gjithsesi nuk do t'ju bëjë të reflektoni dhe t'i bëni një telefonatë.



**BRICJAPI**

Ju mungon vetëkontrolli sot dhe do ta gjeni veten të përfshirë në debate dhe situata që nuk kanë aspak lidhje me ju personalisht.



**UJORI**

Duhet të jeni të hapur me personat që keni pranë vetes. Flisni që t'ju kuptojnë dhe mos vazhdoni të mbylleni më shumë në vetvete.



**PESHQIT**

Keni plane të mëdha për këtë ditë dhe do të mundoheni t'i realizoni sa më shpejt. Ju ka pushtuar shpirti entuziast dhe ndiheni mjaft mirë.

**BARSOLETA E DITËS**



**Djali:** Babë, a prapë ke blerë tokë a?  
**Baba:** I bleva edhe dy hektarë. Kusht të tregojë ty?  
**Djali:** Kali e kish mbyt veten.




**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**“ALPHA” 3D,**

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

**“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”**

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.  
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

**“NIGHT SCHOOL”**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.  
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

**“SIBERIA”,**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.  
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

**“VENOM” 3D,**

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.  
Regjia: Ruben Fleischer  
Based on the Marvel Comics



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

## Bashkëshorti i Whitney Houstonit padit BBC-në



Ish-bashkëshorti i Whitney Houstonit, Bobby Brown, ka paditur Showtime Networks dhe BBC, për përdorimin e paautorizuar të pamjeve në dokumentarin e vitit 2017, "Whitney: Can I Be Me". Padia u paraqit në Gjykatën e Nju Jork

javën e kaluar nga Brown. Në dokumente pretendohet se pamjet dëmtuan Brownin, biznesin e tij dhe pasurinë e Bobbi Kristinas. Këngëtari ka bërë me dije se nuk është marrë pëlqimi i tij për përdorimin e pamjeve, duke shtuar se materiali është rreth 15-vjeçar.

## Mel B vazhdon promovimin e librit të vet



Këngëtarja Mel B vazhdon promovimin e librit të vet "Brutally Honest". Teksa po e promovon librin një gjë që komentohet është paraqitja e thjeshtë e këngëtares. Ajo në pro-

movimin e fundit pati të veshura tuta ngjyrë hiri. Në këtë libër ajo ka treguar jetën e vet duke filluar me pjesëmarrjen në grupin Spice Girl dhe si pjesë e jurisë në X Factor.



## Përfundon 'lufta' Jolie - Pitt, arrijnë marrëveshjen për gjashtë fëmijët

Angelina Jolie dhe Brad Pitt kanë arritur marrëveshjen përfundimtare lidhur me kujdestarinë e gjashtë fëmijëve. Lajmi është bërë me dije nga

avokatja e Angelina Jolie. "Marrëveshja e kujdestarisë është arritur javë më parë dhe është nënshkruar nga të dyja palët", ka thënë avokatja Samantha Bley DeJean.

## Publikohen fotografitë nga ceremonia paramartesore e Priyankas dhe Nickut



Priyanka Chopra dhe Nick Jonas kanë publikuar fotografitë e para të ceremonisë së tyre paramartesore. Këtë ceremoni e organizuan sipas zakoneve indiane, ku festa duhet të organizohet një ose dy ditë para dasmës dhe kjo quhet Mehendi. Në një ceremoni tipike

Mehendi, të gjitha gratë e familjeve të nuses dhe të dhëndrit së bashku me miqtë e ngushtë mblidhen së bashku, ndërsa nusja ka dizajnë të përpunuara të aplikuara në duart dhe këmbët e saj. Chopra 36-vjeçare dhe Jonas 26-vjeçar dukeshin tejet të lumtur përreth miqve.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

WEST BROM - BRENTFORD

1

LEVANTE - ATHLETIC BILBAO

GG

NURNBERG - BAYER LEVERKUSEN

2

# Shorti i Evropianit nuk kursen Kosovën dhe Shqipërinë

Kosova ndaj Anglisë dhe Shqipëria ndaj Francës janë përballjet më interesante për shqiptarët në kualifikimet për Kampionatin Evropian "Euro 2020". "Nuk është grup i lehtë. Ne jemi Kosova. Nuk mund të mendojmë se jemi në një grup të lehtë, pasi Anglia është skuadër shumë e fortë dhe këtë e dimë. Por me skuadrat e tjera është e mundur, kam besim në ekipin tim, i cili është shumë mirë para ndeshjes me Maqedoninë", ka thënë Challandes

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 2 DHJETOR** - Përfaqësuesja e Kosovës dhe Kombëtarja e Shqipërisë të dielën në Dublin i kanë mësuar kundërshtarët për kualifikueset në Evropianin "Euro 2020". Për herë të parë pjesë e këtij shorti ishte edhe Kosova, e cila në këtë ceremoni u përfaqësua nga kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu, përzgjedhësi Bernard Challandes, trajneri Muharrem Sahiti dhe menaxheri i ekipit kombëtar, Bajram Shala. Kosova në Grupin A do të përballlet me gjiganten e futbollit botëror, Anglinë, pastaj Republikën Çeke, Bullgarinë dhe Malin e Zi. "Dardanët", që drejtohen nga përzgjedhësi Bernard Challandes, e kanë edhe një tjetër mundësi për t'u kualifikuar në Kampionatin Evropian, pasi kanë dalë të parët në grup në Ligën e Kombeve dhe me dy fitore të tjera do të kualifikohen në Evropian. Trajneri i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bernard Challandes, ka thënë se favorite absolute e grupit është Anglia, por Kosova ka shanse ndaj kundërshtarëve të tjerë. "Nuk është grup i lehtë. Ne jemi Kosova. Nuk mund të mendojmë se jemi në një grup të lehtë,



pasi Anglia është skuadër shumë e fortë dhe këtë e dimë. Por me skuadrat e tjera është e mundur, kam besim në ekipin tim, i cili është shumë mirë para ndeshjes me Maqedoninë", ka thënë Challandes.

Ndërsa Kombëtarja e Shqipërisë përballë do ta ketë kampionin aktual të botës, Francën, por edhe Islandën, Turqinë, Moldavinë dhe Andorrën. Zvicra e shqiptarëve është në grup me Danimarkën, Irlandën, Gjeorgjinë dhe Gjibraltarin. Trajneri i Shqipërisë, Christian Panucci, ka bërë me dije se kuqezinjtë e synojnë pozitën e dytë në grup. "Mund të shkonte edhe më keq.

Do ta bëjmë të pamundurën. Franca është favorite kryesore. Gjëja më e rëndësishme për ne është t'i rikuperojmë lojtarët. Nëse nuk i kam lojtarët nuk do të kem rezultate. Në Shqipëri nuk interesohen për gjendjen e lojtarëve, vetëm për rezultatin", ka thënë Panucci.

Evropiani 2020 do të ketë 24 skuadra pjesëmarrëse. 20 prej tyre do të caktohen prej këtyre kualifikimeve, që nisin në mars dhe përfundojnë në nëntor të vitit 2019, kurse katër të tjera kualifikohen nëpërmjet "play-off"-it në Ligën e Kombeve, ku Kosova ka siguruar gjysmëfinalen në Ligën D.

GRUPI A	GRUPI C	GRUPI E	GRUPI G	GRUPI I
Anglia Çekia Bullgaria Mali i Zi Kosova	Holanda Gjermania Irlanda Veriore Estonia Bjellorusia	Kroacia Uells Sllovakia Sllovakia Hungaria	Polonia Austria Izraeli Sllovenia	Belgjika Rusia Skocia Qipro
GRUPI B	GRUPI D	GRUPI F	GRUPI H	GRUPI J
Portugalia Ukraina Serbia Lituania Luksemburgu	Zvicra Danimarka Irlanda Gjeorgjia Gjibraltari	Spanja Suedia Norvegjia Rumania	Franca Islanda Turqi Shqipëria Moldavia Andorra	Italia Bosnje & Herc. Finlanda Greqia Armenia Lihtenshtajni

## SHKURT

### Federata e Gjmnastikës, pjesëmarrëse në Baku

Federata e Gjmnastikës e Kosovës po përfaqësohet nga kryetari Besim Halilaj dhe sekretari i Përgjithshëm, Amir Tahiraga, në kongresin e 82-të, ku diskutohen shumë çështje me rëndësi që kanë lidhje me Federatën Internacionale të Gjmnastikës (FIG). Ky kongres po mbahet në Baku të Azerbajxhanit nga data 1 dhjetor deri më 4 dhjetor. Siç dihet, Federata e Gjmnastikës e Kosovës është pranuar me të drejta të plota në Kongresin e FIG-ut, i cili ishte mbajtur më 29-30 tetor të vitit 2014 në Tashken të Uzbekistanit.

### Prishtina fitoi ndaj Trepçës, Besa e mposhti Vëllaznimin

KH Prishtina e mposhti Trepçën me rezultat 31-24. Rezultati pas pjesës së parë ishte i barabartë, 12-12. Në pjesën e dytë prishtinasit shpejt kaluan në epërsi dhe atë e rritën gradualisht për ta shënuar fitoren e dhjetë kampionale. Trepça pësoi humbjen e nëntë dhe është në vend të parafundit me pesë pikë. Me fitore ka vazhduar edhe Besa Famgas që mposhti Vëllaznimin në Pejë me rezultat 32-17. Për Besën është fitorja e 11, kurse për Vëllaznimin humbja e gjashtë. Edhe në ndeshjet Drita-Samadrexha dhe Kastrioti-Drenica fituan skuadrat vendëse që ishin favorite. Drita fitoi ndaj Samadrexhës me rezultat 42-27, kurse Kastrioti ndaj Drenicës me rezultat 43-24.

### Robbeni konfirmon largimin nga Bayerni

Arjen Robbeni ka bërë me dije se në verë do t'i japë fund aventurës te Bayern Muncheni. Gjatë një vizite të klubit të tifozëve, ai ka shpjeguar: "Ky do të jetë viti im i fundit te Bayerni. Kam kaluar 10 vjet të mrekullueshëm. Por, çdo gjë ka një fund". Më parë edhe Uli Hoeness është shprehur se ky do të jetë viti i fundit për Robbenin dhe Riberyn dhe tani ka ardhur deklarata e vet holandezit. Robbeni dhe Ribery janë 34 dhe 35 vjeç, prapëseprapë Karl-Hainz Rummenigge i ka thurur elozhe dyshes së veteranëve. "Ata janë lojtarë që kanë shkruar historinë e klubit. Kemi bërë mirë që kemi rinovuar edhe për një vit me ta".

## Kosova, pas Rumanisë, mposhtet edhe nga Maqedonia

**PRISHTINË, 2 DHJETOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll ka pësuar humbjen e dytë në parakualifikimet për "Eurobasket 2021". Kosova, pas humbjes nga Rumania, në

ndeshjen e zhvilluar në Oradea (88-83), të dielën pësoi edhe humbjen e dytë nga Maqedonia. Në çerekun e parë Maqedonia fitoi 29-16, por Kosova u rikthye në

çerekun e dytë, duke fituar 10-19, derisa pjesa e parë u mbyll me rezultat 39-35. Në çerekun e tretë sërish ishte më e mirë Maqedonia për dhjetë pikë (22-12), kurse në çerekun e

fundit fitoi Kosova 17-21, por kjo nuk mjaftoi për t'iu shmangur humbjes së dytë brenda katër ditësh dhe ndeshja përfundoi me rezultat 78-68.





## Arsenali fiton ndaj Tottenhamit

LONDËR, 2 DHJETOR - Skuadra e Arsenalit e ka fituar ndeshjen që kishte disa herë ndryshim rezultati ndaj Tottenhamit, me rezultat 4-2. Pierre-Emerick Aubameyang e kaloi Arsenalin në epërsi me golin e shënuar nga penalltia. Eric Dier e barazoi

rezultatit në 1-1, kurse Harry Kane me golin e shënuar nga penalltia i kaloi mysafirët në epërsi 1-2. Në pjesën e dytë Arsenali ishte skuadër më e mirë, pasi shënoi dy gola dhe e përmbysi rezultatit ndaj "Spurs"-it. Pierre-Emerick Aubameyang

barazoi shifrat në 2-2, kurse Alexandre Lacazette dhe Lucas Torreira shënuan golat e fitores. Në pesë minutat e fundit Tottenhami luajti pa një lojtar pasi me karton të kuq u ndëshkua Vertonghen. Dyshja shqiptare, Granit Xhaka dhe

Shkodran Mustafi, patën paraqitje të mirë, por u ndëshkuan edhe me kartonë të verdhë. Pas kësaj xhiro Arsenali ngrihet në pozitën e katërt me 30 pikë, kurse Tottenhami një pozitë me pak, me pikë të barabarta me Arsenalin.



## Prishtina, kampione vjeshtore në Superligë



Në gjashtë ndeshjet e fundit të sezonit vjeshtor, fitore kanë shënuar skuadrat mysafire. Prishtina është kampione për këtë sezon, kurse Feronikeli është nënkampion. Tri skuadrat e fundit në tabelë janë Liria, Ferizaj dhe KEK-u

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 DHJETOR - FC Prishtina është kampione vjeshtore në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Në ndeshjen e fundit kryeqytetasit triumfuan në derbin ndaj Dritës me rezultat 2-0. Golat e fitores në këtë ndeshje i realizuan Meriton Korenica, në minutën e 56 dhe Basit Khalid në minutën e katërt të kohës shtesë. Prishtina e mbylli këtë sezon në vendin e parë me një pikë më shumë se skuadra e Feronikelit e cila renditet e dyta. Ndërsa kampionia aktuale e elitës, Drita, e përfundon sezonin vjeshtor në pozitën e gjashtë me 23 pikë. Feronikeli në këtë xhiro e mposhti skuadrën e Flamurtarit nga Prishtina (2-0). Në minutën e 16 Yll Hoxha realizoi për 1-0. Me këtë

rezultat përfundoi pjesa e parë, kurse në pjesën e dytë vendësit shënuan edhe golin e dytë dhe të fundit në ndeshje. Realizator ishte Kastriot Rexha, në minutën e 56. Fitores i është gëzuar edhe skuadra e Llapit që mposhti Lirinë me rezultat minimal 1-0 derisa të vetmin gol e realizoi kapiteni Hamdi Namani. Me këtë fitore llapjanët mbesin në hap me dy skuadrat e para në tabelë. Goli i Ansi Nikës i solli tri pikë skuadrës së Gjilanit në përballje me skuadrën e Ferizajt (1-0). Ndërkohë, Drenica e ka deklasuar KEK-un, duke e mposhtur me rezultat 5-1. Golashënues në këtë ndeshje ishin Armend Abazi (20', 87'), Mziu (31'), Ermal Veliqi (55') dhe Diar Mustafa (60'), kurse golin e vetëm për KEK-un e ka shënuar Nimani (90'). Trepça '89 e mbylli sezonin vjeshtor me

## IPKO SUPERLIGA

Prishtina - Drita	2-0
Trepça '89 - Ballkani	1-0
Gjilani - Ferizaj	1-0
Drenica - KEK-u	5-1
Llapi - Liria	1-0
Feronikeli - Flamurtari	2-0

## Tabela

	PIKË
1. Prishtina	40
2. Feronikeli	39
3. Llapi	35
4. Gjilani	27
5. Drenica	24
6. Drita	23
7. Trepça'89	22
8. Flamurtari 22	
9. Ballkani	21
10. Liria	19
11. Ferizaj	15
12. KEK-u	1

## LIGA E PARË

Istogu - Kika	4-1
Fushë Kosova - Dukagjini	0-1
Trepça - Vitia	1-2
2 Korriku - Onix	2-2
Drenasi - Ramiz Sadiku	2-1
Vushtrria - Vëllaznimi	1-0
Bashkimi - Arbëria	5-2
Besa - Vllaznia	5-2


## Tabela

	PIKË
1. Vushtrria	38
2. Besa	35
3. Dukagjini	33
4. Vitia	31
5. Vëllaznimi	29
6. Onix	26
7. Trepça	24
8. Arbëria	22
9. Istogu	20
10. 2 Korriku	18
11. Drenasi	18
12. Kika	15
13. Ramiz Sadiku	15
14. Fushë Kosova	14
15. Bashkimi	12
16. Vllaznia	8

fitoren e arritur ndaj Ballkanit (1-0), ku golin e vetëm e shënoi Martin Mircevski në minutat shtesë të ndeshjes.

## Golden State pëson një tjetër humbje

OAKLAND, 2 DHJETOR - Golden State Warriors është mposhtur 111-102 në fushën e Detroit, duke pësuar humbjen e nëntë sezonale. Një ndeshje e dominuar nga vendësit, që u shkëputën gradualisht që në pjesën e parë dhe e ruajtën avantazhin deri në fund, sfidë ku diferencën e bëri Griffin me 26 pikë. Për Golden State një lajm i mirë është rikthimi në fushë i Curryt pas tre javësh pushim, duke realizuar 27 pikë. Mirë u paraqitën edhe Duranti me 28 pikë e Thompsoni me 21 pikë, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Në Lindje, skuadra e Toronto Raptorsit vijon të bëjë një paraqitje të shkëlqyer, duke komanduar renditjen dhe duke u bërë



ekipi i parë që arrin kuotën e 20 fitoreve këtë sezon. Kanadezët fituan 106-95 në fushën e Clevelandit, me miqtë që dominuan në shumicën e kohës. Leonardit me 34 pikë ishte shënuesi më i mirë për Toronton. Mirë po paraqitet edhe Bostoni, që mundi 118-109 Minnesota, ndeshje e dominuar

nga basketbollistët e Celticsit, ku u dallua Hayward me 30 pikë (e nisi ndeshjen nga stoli). Pas kohës shtesë fiton New York, që mundi 136-134 Milwaukee, një ndeshje me rivalitet dhe emocione gjatë gjithë kohës. Milwaukee (Antetokounmpo 33 pikë e 19 rebounde) pati mundësinë ta fitonte këtë sfidë që në kohën e rregullt, teksa u shkëput deri në 17 pikë, por gaboi në fund. Për njujorkezët u dalluan Mudiay me 28 pikë e Knoxi me 26. Fiton edhe ekipi i Houston Rocketsit, që mundi me lehtësi 121-105 Chicago Bullsit, ndeshje e dalluar nga vendësit, ku diferencën në fushë e bëri James Hardeni me 30 pikë.

## SHKURT

### Wilderi dhe Fury ndahen baras

Sfida e shumëpritur e peshës së rëndë mes boksierit amerikan Deontay Wilder dhe atij britanik Tyson Fury është mbyllur në barazim. Një nga gjyqtarët ka dhënë rezultatit 115-111 në favor të Wilder, tjetri 114-110 në favor të Furyt dhe i treti në barazim, 113-113. Për pasojë, titulli kampion bote i peshës së rëndë në kategorinë WBC qëndron në duart e Wilderit, ndërkohë që të dy boksierët qëndrojnë të pamposhtur. Wilderi tashmë ka rekordin e 40 fitoreve e 1 barazim në karrierën e tij, ndërsa Fury 27 fitore e 1 barazim. Dueli u zhvillua në orët e para të mëngjesit të së dielës në stadiumin "Staples Center" të Los Angelosit, mes 20 mijë shikuesve, me Furyn që bëri një paraqitje më të mirë në shumicën e raundeve, duke i fituar ato. Por britaniku ra dy herë në tapet, në raundin e nëntë dhe të 12-, çka e ndihmoi Wilderit ta rikuperojë disavantazhin e pikëve që kishte. Të dy boksierët e mbyllën duelin duke festuar fitoren, por në fund nuk kishte një fitues, çka lë të hapur mundësinë për një revansh.

### Arbër Zeneli ia dedikon golin gjyshit që i ndërroi jetë

Ylli i Kosovës në futboll, Arbër Zeneli, po e vazhdon formën brilante edhe në Eredivisie. Ai ka realizuar golin e dytë për Heerenveenin, në përballjen kundër Sittardit. Golin Arbëri e realizoi nga pika e bardhë, në minutën e 47 të këtij takimi. Pasi e dërgoi topin në rrjetë, në festimin e tij, Zeneli tregoi një bluzë ku shkruante: "Babagjysh këtë gol ta dedikoj ty".

### Feuzi triumfon në pistën e Beaver Creekut

Gara e zbritjes së lirë për meshkuj, e vlefshme për Kupën e Botës në ski e zhvilluar në pistën amerikane të Beaver Creek, u fitua nga skiatori zviceran Beat Feuz. Ai ishte më i shpejtë në pistë në të dyja zbritjet, duke dhënë kohën e përgjithshme 1'13"59, suksesi i parë sezonal për të. Në vendin e dytë u rendit një tjetër skiator zviceran, Mauro Caviezel, ndërsa i treti u klasifikua norvegjezi Aksel Svindal. Gara pati edhe një moment paniku, kur skiatori gjerman Thomas Dressen, 25 vjeç, doli nga pista dhe u përplas me rrjetat mbrojtëse. Ai u ngre falë ndihmës së ndihmës së shpejtë dhe u dërgua me helikopter në spital, duke bërë që gara të ndërpritet për 20 minuta. Për sa i përket renditjes së përgjithshme të Kupës së Botës, një emër surprizë është në krye të saj, austriaku Vincent Kriechmayer, me 175 pikë, një më shumë se Feuzi. Në vendin e tretë të Kupës së Botës ndodhet zvicerani tjetër Mauro Caviezel.

### Kasami shënon dhe asiston në fitore e Luzernit

Ylli me prejardhje shqiptare, Pajtim Kasami, ka shkëlqyer në ndeshjen në mes të Sionit dhe Luzernit. Sioni ka fituar me rezultat 2-0 në ndeshjen e luajtur në shtëpi ndaj Luzernit në kuadër të javës së 16 të Superligës së Zvicrës. Në këtë ndeshje ka lënë shenjë reprezentuesi shqiptar i Zvicrës, Pajtim Kasami. Djaloshi nga Struga ka shënuar një supergol dhe ka asistuar në golin e dytë të Sionit. Goli i Kasamit erdhi në minutën e 79 të ndeshjes dhe ishte i epërsisë 1-0 për skuadrën e tij.

Autor: GAZMEND MORINA	KOMIKU ANGLEZ NË FOTO 1	NJËRA NËDËR TRI GJINITË KRYESORE TË KRIJIMTARISË LETRARE	YLLI ME BISHT	ISH MAFIOZI .. KAPONE	ENDACAK	EPOKA E RE	QYTET I LASHTË NË ILIRI	ZANORE	LLOJ SHPENDE ME QAFË TË GJATË	INDIUM	DRU QË RRRITET NË VENDET MESDHETARE; LAR	ELEKTRON, SILIC	1				
VEGËL DORE, QË PËRBËHET NGA NJË KOKË METALI						E VRULLSHME GJOKS (FEM.)											
PËRPJEKJE PËR TA MBROJTUR E PËRLIGJUR DIÇKA TË GABUAR E TË PADREJTË								VENDE S FEMRA LUFTËTARE (mit. greke.)									
VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE KËNGËTARJA VEJSIU				INSEKT I MËRZITSHËM (sh.shq.) BASHKËTING.					FINLANDA, ITALIA MBETEM PA GOJË; SHASTISEM								
						SHTET AZIATIK LUMË NË AUSTRI						QYTET UNIVERSITAR NË ANGLI					
INSTITUTE ANIMAL TECHNOLOGY				HUMORISTI BESIM TRAJNERI HOLANDEZ ... HAN				KËNGËTARJA JONË E RE ... KOÇI ASTAT									
BASHKËTING.		SHKRONJA TË NJËJTA HUQ; SHPREHI E KEQE			REKRUTËT NË PERANDORINË OSMANE KRYEQYTETI I NJË SHTETI EVRO-AZIATIK												
AGIM VATOVCI			"RADIO TELEVISIONI ITALIAN" QË NUK I PËRKET FESË DHE KLERIT				ATLETJA E NJOHUR MERLIN DRAMË E SANTORIT			ZANORE KRYEQYTETI I KANADASË		KËNGËTARJA JONË E RE KRASNIQI		QË KA TË BËJË ME HËNËN	FILM I YNI "... ISHIN KATËR"	VITI I RI KINEZ	LLOJ KARROCE ME KATËR RROTA, E TËRHEQUR PREJ KUAJSH
BIMË BARISHTORE SHUMË E HIDHUR						ESTONIA, NORVEGJIA AGIM TEJECI			TONI "RIMINI"								
LITËR; SULFUR; AMPER				VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE (sh.shq.) FAMA								VEPRIMTARI MARTIN .... KING QYTET I MADH NË ZVICËR					
INDIANA		MËRIA, ZILIA ELEKTRODA E POLIT POZITIV					AFTËSIA E NJERIUT PËR TË KRIJUAR KËNGËTARJA E SHQUAR FRENKLIN										
SMIRË						KORNIZË AKTORI SHQIPTARO-AMERIKAN NË FOTO 2				PRODUKT I PULËS SHTET FEDERAL NË SHBA				IDRIZ BALAJ I FILLOJ			
<b>EPOKA E RE</b>	BASHKËTING. PËRMBLEDHJE E SISTEMUAR E NORMAVE JURIDIKE		HUNGAREZ (vjet.) JEVG						QENGJI I BUTË MOLDE					ZANORE FUTBOLLISTI YNË BAJRAMI (shq.)			
ZABEL							EMINE (perkdh.) ELIZABETH BANKS			ERJON BOGDANI ZANORE			NEON BASHKËTING.			CILI MË RADHË	
FUTBOLLISTI ITALIAN MASIMO (MILAN)				TRAJENRI SHOSHOLLI ZANORE				RRAFSHIM; BARAZIM LARTËSISH (shq.) NJË PLANET									
FIGURË SHAHU					KA TË NGJARË, KUSHEDI					ARTIOLA TOSKA KRYEPROK-URORJA E SHQIPËRISË ... RAMA			SILIC, SULFUR ENË QELQI ME GRYKË TË GJERË E ME KAPAK				
					BASHKËTING.		GOJËTAR	KAMPIONI SHKRONJA XVI				ADRIAN KRASNIQI		"RAGUZA" FUTBOLLISTI I NJOHUR I MANCHESTER UNITED			
					KLUB FUTBOLLI ANGLEZ						THEMELUESI I TURQISË MODERNE MUSTAFA .... ATATURK	AKUZUES I SOKRATIT LLOJ GAZI ME ERË TË FORTË					
					ERBIUM			U ZATETA UNDERWATER ELECTRIC KITE					IPSVICH ARRATISUR				
					KËNGËTARJA E NJOHUR PAUSINI					THIRRJA E MYEZINIT SHKRONJA TË NJËJTA					NEVOJË E THEKSUAR QË KEMI PËR TË NGRËNË		
										SHALQI (shq.) DY BASHKËTINGËLLORE							
					ELEMENT KIMIK JARAN			VEGËL MUZIKORE SIENA					"URUGUAI" ZANORE				
					"IRLANDA"			MËNYRË E VEÇANTË E TË VESHURIT					MUNDIMI; VËSHITËRËSIA				

ZGJIDHJA E FJALËKRITIT: ÇEKAN, RAPIDE, APOLOGJI, ANAS, RIM, MIZAT, FI, ALKETA, OMANI, IAT, DINA, ENI, Ç, AA, NIZAMËT, AV, RAI, OTI, O, PELIN, EN, TONELATA, LSA, KAMARËT, LUTËR, I, INATI, IMAGJINATA, NAKAR, RAM, VEZA, IB, N, MAXHAR, MANARI, A, KORJË, EMI, EB, NE, ODO, AJET, NIVELIMI, DAMA, MBASE, AT, SIS, S, ASI, AK, RA, BOLTON, ANIT, ER, U TAKOVA, I, LAURA, EZANI, EN, TONELATA, LSA, KAMARËT, LUTËR, I, INATI, IMAGJINATA, NAKAR, RAM, VEZA, IB, N, MAXHAR.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
Ministarstvo za Kulturë, Omladinu i Sport  
Ministry of Culture, Youth and Sports

## Çmimet në fushën e Trashëgimisë Kulturore

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në përputhje me Rregulloren NR.09/2016 për Dhënie e Çmimeve në fushën e trashëgimisë kulturore, shpall:

### KONKURS

Për çmimet që i ndan Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në fushën e trashëgimisë kulturore. Ftohen të interesuarit që të propozojnë kandidatët për Çmimin për Veprimtari Jetësore në fushën e trashëgimisë kulturore "Dea Dardanicæ", Çmimin Vjetor për Merita të Veçanta "Shtjefën Gjeqovi", Çmimin Vjetor për Vepër Shkencore "Zef Mirdita" dhe Çmimin Vjetor për Menaxhim Institucional "Muhamed Shukriu".

#### Çmimi për Veprimtari Jetësore në Fushën e Trashëgimisë Kulturore "Dea Dardanicæ"

Ky Çmim u jepet personalitetëve të shquara, profesionistëve të dalluar, të cilët me angazhimin e tyre të vazhdueshëm kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në avancimin e trashëgimisë kulturore si dhe kanë nxitur të arriturat në mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë profesionistët, studiuesit dhe hulumtuesit në fushën e trashëgimisë kulturore, shtetas të Republikës së Kosovës dhe shtetas të vendeve të tjera.

#### Çmimi Vjetor për Merita të Veçanta "Shtjefën Gjeqovi"

Ky Çmim u jepet personalitetëve të dalluara në fushën e trashëgimisë kulturore, për angazhimin, kontributin dhe të arriturat përgjatë vitit për përmbushjen e detyrimit kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë profesionistët, studiuesit dhe hulumtuesit në fushën e trashëgimisë kulturore, shtetas të Republikës së Kosovës dhe shtetas të vendeve të tjera.

#### Çmimi Vjetor për Vepër Shkencore "Zef Mirdita"

Ky Çmim u jepet autorëve për vepër shkencore në fushën e trashëgimisë kulturore.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë profesionistët, studiuesit dhe hulumtuesit në fushën e trashëgimisë kulturore, shtetas të Republikës së Kosovës dhe shtetas të vendeve të tjera.

#### Çmimi Vjetor për Menaxhim Institucional "Muhamed Shukriu"

Ky Çmim u jepet udhëheqësve të institucioneve dhe punonjësve të institucioneve publike dhe jopublike që në mandat kanë mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë udhëheqësit dhe punonjësit e institucioneve publike dhe jopublike të institucioneve të trashëgimisë kulturore shtetas të Republikës së Kosovës.

Vlerësimin për dhënie e çmimeve e bën juria profesionale.

Konkurrimi për Çmimet në fushën e trashëgimisë kulturore mund të bëhet përmes propozimit nga:

Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës (për tri çmimet e para);

Institucionet e trashëgimisë kulturore;

Institutet shkencore, arkivat, muzetë;

Fakultetet e universiteteve publike si dhe private të Republikës së Kosovës;

Shoqatat dhe organizata që merren me trashëgimisë kulturore;

Personat fizikë dhe juridikë.

Propozimi duhet të përmbajë:

- Dokumentacion personal (kopje e dokumentit identifikues);
- Biografia me fokus në veprimtarinë për të cilin çmim nominohet;
- Dëshmitë relevante për kontributet e publikuara të nominuarëve (abstraktet e publikimeve nga fusha për të cilën nominohen, dëshmia dhe përmbajta e projekteve profesionale apo shkencore, vlerësimet dhe rekomandimet për kontribut në menaxhimin institucional në fushën për të cilën nominohet).

Propozimi duhet të nënshkruhet nga titullari që ka të drejtën e propozimit.

**Propozimet me shkrim duhet të dërgohen deri me 31 Dhjetor 2018 në adresën:**  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit /Departamenti Trashëgimisë Kulturore, Zyra Nr. 22 Adresa : Sheshi "Nëna Tereze" nr. 35, Prishtinë  
Rregulloren mund ta gjeni në webfaqen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit:  
[www.mkrs-ks.org](http://www.mkrs-ks.org)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
Ministarstvo za Kulturë, Omladinu i Sport  
Ministry of Culture, Youth and Sports

## Nagrade iz oblasti Kulturne Baštine

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, u podudarnosti sa Pravilnikom e BR.09/2016 za Dodelu Nagrada iz oblasti kulturne baštine, objavljuje:

### KONKURS

Za nagrade koje dodeljuje Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta iz oblasti kulturne baštine. Pozivaju se zainteresovani da predlože kandidate za Nagradu za Životno Delo iz oblasti kulturne baštine "Dea Dardanicæ", Godišnje Nagrade za Posebne Zasluge "Shtjefën Gjeqovi", Godišnje Nagrade za Naučno Delo "Zef Mirdita" i Godišnje Nagrade za Institucionalno Upravljanje "Muhamed Shukriu".

#### Nagrada za Životno Delo iz oblasti Kulturne Baštine "Dea Dardanicæ"

Ova se nagrada dodeljuje istaknutim ličnostima, istaknutim profesionalcima, koji su, svojim stalnim angažovanjem imali direktan uticaj u unapređenju kulturne baštine kao i, podstakli dostignuća u zaštiti, očuvanju i promovisanju kulturne baštine Kosova.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

#### Godišnja nagrada za Posebne Zasluge "Shtjefën Gjeqovi"

Ova se nagrada dodeljuje istaknutim ličnostima iz oblasti kulturne baštine, za angažovanje, doprinos i dostignuća tokom godine, za ispunjavanje ustavnih i zakonskih obaveza za zaštitu, očuvanje i promovisanje kulturne baštine Kosova.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

#### Godišnja nagrada za Naučno delo "Zef Mirdita"

Ova se nagrada dodeljuje autorima za naučno delo iz oblasti kulturne baštine.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

#### Godišnja nagrada za Institucionalno Upravljanje "Muhamed Shukriu"

Ova se nagrada dodeljuje rukovodiocima institucija i radnicima javnih institucija koji u svom mandatu imaju zaštitu, očuvanje i promovisanje kulturne baštine.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

Procenjivanje o dodeli nagrada vrši profesionalan žiri.

Konkurisanje za Nagrade iz oblasti kulturne baštine mogu da se izvrše preko predlaganja od:

Akademije Nauke i Umetnosti Kosova (za tri prve nagrade);

Institucija kulturne baštine;

Naučnih Instituta, arhivat, muzeja;

Javnih fakulteta i univerziteta Republike Kosova;

Društava i organizacija koja se zauzimaju kulturnom baštinom;

Fizičkih i pravnih lica.

Predlog treba da sadrži:

- Ličnu dokumentaciju (kopija dokumenta za identifikovanje);
- Biografij sa fokusom na delatnosti za nagradu za koju se nominira;
- Relevantne dokaze za objavljene doprinose nominiranih (objavljeni abstrakti za oblast za koju se nominiraju, dokaz i sadržaj profesionalnih ili naučnih projekata, ocenjivanja i preporuke za institucionalno upravljanje iz oblasti za koju se nominira).

Predlog treba da se potpiše od titulara koji ima pravo na predlaganje.

**Pismeni predlozi mogu da se pošalju do 31. Decembra 2018 na adresu:**  
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /Departman Kulturne Baštine, kancelarija Br. 22 Adresa : Trg "Majke Tereze" br. 35, Priština  
Pravilnik u web stranici Ministarstva, Kulture, Omladine i Sporta  
[www.mkrs-ks.org](http://www.mkrs-ks.org)



## Shpallje Publike

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, Seksionin V Pikën 3 (c) të Rregullores së KEK-ut Sh.a dhe nevojave të paraqitura për plotësimin e disa vendeve të lira të punës në Divisionet e KEK-ut, Divizioni i Burimeve Njerëzore, më 30.11.2018 publikon ofertën për pozitat e mëposhtme:

### 1. Ekspert i lartë për përfaqësime (1 kryerës)

#### Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Përfaqëson KEK sh.a para gjykatave të kompetencës së përgjithshme dhe atë ekonomik, në të gjitha nivelet në kontestet gjyqësore qoftë palë e paditur apo paditëse, si dhe para organeve administrative, gjykatave për kundërvajtje dhe institucioneve shtetërore.

Hënë ushtrimin e padive, propozimeve dhe akteve të tjera për fillimin e procedurës gjyqësore, vërtetimin e gjendjes faktike dhe sigurimin e provave materiale në bashkëpunim me shërbimet përkatëse të KEK sh.a dhe organeve të pushtetit lokal apo atij qendror, ushtrimin e ankesave (njartet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike) parashtesave, akteve të tjera procedurale sipas urdhrorit të gjykatës apo me vet iniciativë lidhur me kontestin merr pjesë në cilësinë e përfaqësuesit në shqyrtimin e çështjeve para gjykatave dhe organeve të tjera.

Kujdeset dhe përcjell përmbardimin e aktgjykimeve gjer në përfundimin e çështjes lidhur me aktgjykimet, aktvendimet (të formës së prerë) me propozim për përmbardim në afatin ligjor ndaj debitorëve të KEK sh.a. Shqyrtor dhe merr veprime ndaj propozim përmbardimeve të drejtuara nga kreditorët kundër KEK sh.a, vërteton bazën juridike dhe njëkohësisht rekomandon për dhënie e urdhrorit për pagesë apo kundërshtim në propozim përmbardim.

Harton raport të punës Raporti është mujor, tremujor, gjashtëmujor dhe vjetor, dhe punë tjera që i caktohen nga mbikëqyritësi,

#### Përgjegjësitë tjera më të përgjithshme do të përfshijnë:

Suksesi efektiv në përfaqësime të KEK sh.a:  
Ndikimi në zvogëlimin e shpenzimeve gjyqësore për KEK-un sh.a;  
Është përgjegjës për kryerjen e punëve me profesionalizëm, efikasitet dhe ndershmëri;  
Vepron në kuadër të autorizimit, por është përgjegjës nëse e bënë tejkalimin e autorizimit;  
Është përgjegjës për lëshime profesionale, mosndërmarrja e veprimeve të duhura në mbrojtjen efitike të interesave të KEK sh.a;  
Është përgjegjës për saktësinë e shënimeve, për arkivimin, ruajtjen e lëndëve gjyqësore  
Është përgjegjës për respektimin e rregullave të disiplinës në punë, sjelljen korrekte me bashkëpunëtorë, dhe persona të tjerë si brenda KEK sh.a ashtu edhe jashtë tij

#### Autorizimet:

Të gjitha autorizimet të dhëna me kontratë dhe autorizimet me shkrim nga menaxheri i Departamentit ligjor apo dhe Drejtori i Zyres Ligjore.

#### Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Kualifikimi universitar – fakulteti juridik, preferohet minimum 3 vite përvojë pune profesionale; Njohuri për legjislacionin në fuqi dhe procedurat gjyqësore dhe administrative.

### 2. Ekspert i lartë për pronë (1 kryerës)

#### Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i vendit të punës përfaqëson KEK sh.a para gjykatave të kompetencës së përgjithshme dhe atë ekonomik, në kontestet gjyqësore qoftë palë e paditur apo paditëse, si dhe para organeve administrative dhe institucioneve shtetërore.

Hënë ushtrimin e padive, propozimeve dhe akteve të tjera për fillimin e procedurës gjyqësore, vërtetimin e gjendjes faktike dhe sigurimin e provave materiale në bashkëpunim me shërbimet përkatëse të KEK sh.a dhe organeve të pushtetit lokal apo atij qendror, ushtrimin e ankesave (njartet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike) parashtesave, akteve të tjera procedurale sipas urdhrorit të gjykatës apo me vet iniciativë lidhur me kontestin merr pjesë në cilësinë e përfaqësuesit në shqyrtimin e çështjeve para gjykatave dhe organeve të tjera.

Kujdeset dhe përcjell përmbardimin e aktgjykimeve gjer në përfundimin e çështjes lidhur me aktgjykimet, aktvendimet (të formës së prerë) me propozim për përmbardim në afatin ligjor ndaj debitorëve të KEK sh.a.

Shqyrtor dhe merr veprime ndaj propozim përmbardimeve të drejtuara nga kreditorët kundër KEK sh.a, vërteton bazën juridike dhe njëkohësisht rekomandon për dhënie e urdhrorit për pagesë apo kundërshtim në propozim përmbardim.

Evidentimin dhe mbrojtjen juridike të pronës Në bashkëpunim me departamentet përkatëse merr pjesë në përgatitjen e materialeve për shpronësim.

Marrëdhëniet: Për rezultatet e punës së vetë i raporton Menaxherit të Departamentit Ligjor dhe Drejtorit të Zyres Ligjore. Autorizimet: Jap mendime profesionale dhe merr pjesë në përpilimin e kontratave që kanë të bëjnë me patndshëri të KEK sh.a. Të gjitha autorizimet të dhëna me kontratë dhe autorizimet me shkrim nga Drejtori i Zyres Ligjore dhe Menaxheri i Departamentit juridik

#### Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Kualifikimi universitar – fakulteti juridik Njohuri për legjislacionin në fuqi dhe procedurat gjyqësore dhe administrative.

### 3. Ekspert i larte për rekrutim (1 kryerës)

#### Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i vendit të punës Eksperti i lartë për rekrutim udhëheq dhe vepron në kuadër të Sektorit për rekrutim duke u kujdesur për selektimet, rekrutimet, avancimet, ritrajtimet dhe transferimet e punëtorëve në kuadër të KEK-ut.

Në mënyrë sa më profesionale bënë selektimin dhe rekrutimin e fuqisë punëtore, duke filluar nga përgatitja e shpalljeve, qoftë interne apo publike, seleksionimi i ngushtë i kandidatëve, zgjedhja e anëtarëve të komisionit, aranzhimi i intervistave, dhe participimi në intervista

Përgatit procesverbalet pas përfundimit të intervistave Përgatit njoftimin me shkrim për punëtorin e pranuar dhe njësinë në të cilën është pranuar Pas përfundimit të procedurës zyrtare për rekrutim, përgatit njoftimin me shkrim dhe informon të gjithë aplikantët që kanë aplikuar për këtë pozitë për përfundimin dhe rezultatin e shpalljes.

Planifikon transferet e punëtorëve në kuadër të KEK-ut, duke harmonizuar kërkesat dhe duke pasur parasysh potencialin ekzistues.

Kujdeset për plotësimin me punëtor të vendeve të reja të punës apo vendeve të cilat përkohësisht mbeten të pambuluara si dhe të vendeve që paraqiten të lira për shkak të pensionimit, largimit të punëtorit për shkaqe të ndryshme nga puna, etj.

Përcjell nevojat për transferet e punëtorëve në kuadër të Divizionit, duke harmonizuar kërkesat dhe duke pasur parasysh potencialin ekzistues.

Përcjell nevojat për plotësimin me punëtor të vendeve të reja të punës apo vendeve të cilat përkohësisht mbeten të pambuluara si dhe të vendeve që paraqiten të lira për shkak të pensionimit, largimit të punëtorit për shkaqe të ndryshme nga puna, etj.

#### Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Kualifikimi universitar – fakulteti juridik, preferohet minimum 3 vite përvojë pune profesionale; Njohuri për legjislacionin në fuqi dhe procedurat gjyqësore dhe administrative.

### 4. Zyrtar larte për Raportime (1 kryerës)

Zyrtari i lartë për raportime është person ndërlidhës i menaxhimentit dhe Bordit të Drejtorëve, në njërin anë dhe në anën tjetër, aksionarëve, Qeverisë së Kosovës, e ne veçanti Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik me qëllim të realizimit të obligimeve ligjore të ndërmarrjes për raportim. Sipas kërkesë ai do t'i asistojë edhe Sekretarit të Korporatës në takimet e Bordit të Drejtorëve .Përgatit raporte sipas kërkesës së Bordit, menaxhimentit dhe Sekretarit të Korporatës, në funksion të realizimit të obligimeve ligjore për raportim tek institucionet qeveritare e shtetërore:Asiston Sekretarin e Korporatës në përgatitjen e materialeve zyrtare për takime të bordit dhe të komiteteve, dhe në realizimin e rolit dhe detyrave tipike të sekretarit të korporatës, duke përfshirë (i) mbajtjen e regjistrit të aksionarëve dhe drejtorëve; (ii) mbajtjen e të gjitha dosjeve të nevojshme, publikimeve dhe/ose shpalljeve për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë; Asiston Sekretarin e Korporatës në komunikimin zyrtar me organet shtetërore, rregullatorët e agjencitë tjera të pavarura;Kujdeset për mirëmbajtjen e dosjeve dhe materialeve tjera zyrtare në rregull, konform me normat përkatëse ligjore në fuqi;Çdo punë tjetër të caktuar kohe pas kohe nga Sekretari i Korporatës

Marrëdhëniet: Zyrtari i lartë për Raportim i përgjigjet Sekretarit të Korporatës.

Autorizimet: Në pajtueshmëri me rregulloret e KEK ut dhe nivelin e kompetencës të përcaktuara kohe pas kohe nga Sekretari i Korporatës, Menaxhmenti dhe, indirekt edhe nga Bordi i Drejtorëve

#### Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Kualifikimi universitar – fakulteti juridik, preferohet minimum 3 vite përvojë pune profesionale; Njohuri për legjislacionin në fuqi dhe procedurat gjyqësore dhe administrative.

Arsimin e lartë universitar – Fakulteti ekonomik drejtimi Menaxhimi i politikave-administrate publike. Përvojë pune 3 vite. Përvojë profesionale në komunikim ndër-institucional, pastaj qeverisje të korporatës dhe/ose për shoqëritë tregtare, organizimin dhe operimin e tyre. Njohuri të avancuar të gjuhës angleze.

### 5.Drejtor i Njësisë për Menaxhimin e Projektit PRT (1 kryerës)

#### Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

